

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7452 E hënë 26 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
A jo çfarë pritet të dalë në zgjedhjet e ditës së diel në Itali, është vendimtare jo vetëm për Italinë, por mbi të gjitha për vetë Brukselin. Rezultati i tyre nuk ka të bëjë...
Vijon në faqen 20

Nga MONIKA STAFA
Renzi, Berlusconi apo të dy bashkë?!


Opinion **Ditës**
Kosova dhe Serbia po ecin drejt një pike, ku duhet të nënshkruajnë kthesën e madhe në marrëdhëniet e tyre dypalëshe. Strategjia e Komisionit Europian për...
Vijon në faqen 21

Nga SHABAN MURATI
Pse Prishtina nuk flet për njohjen e Kosovës nga Serbia?



Formula ku duhet të bazoheni për të mos gabuar

Llogaritja e pensioneve, tabela me koeficientët e indeksimit të pagave që prej vitit 1994

Shembuj konkretë të përcaktimit të masës së përfitimit, bazuar në pagën që ka pasur individi

Nga VOLTIZA DURO

J o pak individë që marrin pension shpeshherë janë të paqartë në lidhje me përlogaritjen e masës e kërkojnë përgjigje nga ekspertët e fushës së sigurimeve shoqërore. Sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", pensioni i pleqërisë përbëhet...

Në faqen 8

JUNCKER NE TIRANE: SHQIPERIA, REFORMA IMPRESIONUESE, PROGRES MBRESELENES

PRESIDENTI I KE: ZGJIDHNI PROBLEMET ME GREQINE

Rama: Duam rekomandim të qartë për BE. Për paktin detar sqarimet i ka Presidenti në tryezë. Kreu i KE-së sot në mesditë takon Metën



(Në foto) Presidenti i KE, Jean Claude Juncker dhe kryeministri Edi Rama

"PROCES TRANSPARENT"

Ushtarakët në test për të shkruar në misione, ministria Xhaçka: Vlerësim sipas meritës

Në faqen 5

INTERVISTA

Bochardt: Në zgjedhjet e 2019 me teknologji të re, depolitizim të procesit të numërimit

Në faqen 6

12 GEZHOJA NE VENDNGJARJE

Pasi pinë bashkë gjithë natën, kryetari i PS në Kelmend qëllon me armë zjarri Mark Cekajn

Në faqen 9

"KU CENOHEN QYTETARET"

Avokati Lapaj: Disa propozime për ndryshime në projektligjin "Për strehimin social"

Në faqen 10-11

KESHILLA NE 'LIFEPAGES'
Albana Duni
Pankreasi dhe mënyrat si ta pastrojme organin e rëndësishëm, flet mjekja gastrohepatologe, Duni
Suplement


Ish-pronarët që janë kundër vlerësimit financiar mund të ankimojnë

ATP: Lista II me 1500 dosjet e '97, vlerësimi për çdo pronar

Përfituesit në të gjithë vendin, dokumentet për të marrë paratë

Nga ORNELA MANJANI

A gjenca e Trajtimit të Apronat ka vlerësimet financiare për ish-pronarët që kanë dorëzuar kërkesën për kompensim në vitin 1997. Agjencia bën të ditur se në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të ad-



ministruar pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara...

Në faqet 17-18

BISEDIMET ME GREQINE REAGIMET

Pakti me Greqinë, ish-kryeministri akuza të forta ndaj qeverisë

Berisha: Rama e Bushati tradhtarë, shitën naftën e fshinë "Çamërinë"

"Shqiptarët të ngrihen kundër kësaj klike"

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje, kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati për tradhti kombëtare. Përmes një statusi në rrjetin social, "Facebook", Berisha tha se "Kapitullimi i Edvinit dhe Ditziu të tij për "çështjen çame", është akti më poshtëruar në historinë tonë". "Ministri i Jashtëm i Greqisë informoi një deputet grek me një letër të botuar në media, se në negociatat me Ramën dhe Ditziuin e tij ai jo vetëm ka siguruar fushatë dhe gazetë dhe naftë më të mëdha të Jonit dhe Mesdheut për Greqinë, por edhe se me palën shqiptare kanë rënë dakord që të fshihen nga faqja e dheut fjalët "çam" dhe "Çamëri", të zhduken këto fjalë nga tekste, botimet, nga historia jonë kombëtare, gjeografia, debatet dhe çdo gjë tjetër", bëri të ditur Berisha. "Kjo kërkesë për palën greke përbën kërkesën më albanofobe, fondamentaliste, të pashembullt në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe unë e kam denoncuar këtë me forcën më të madhe", u shpreh Berisha. Por, sipas tij, vetë diskutimi dhe pranimi i kësaj kërkesë nga Edvini dhe Ditziu i tij është kapitullimi më poshtëruar i regjistruar ndonjëherë në historinë tonë. "Me këtë akt të paimagjinueshëm Rama dhe Ditziu i tij kanë tejkaluar edhe masakrat e Zervës dhe barbaritë e Enver Hoxhës ndaj popullatës të martirizuar të Çamërisë dhe dheut shekullor të saj. Edi Rama dhe Ditziu i tij kanë shkëlmuar mbi gjakun, vuajtjen, sakrificat mbinjerëzore të çamëve, kontributin e tyre të pavdekshëm".



Ish-kryeministri Sali Berisha

thikë të tmerrshme mbas shpine ndaj çamëve dhe Çamërisë së martirizuar, u bëj thirrje shqiptarëve të ngriheni në revoltë kundër kësaj klike neoblokmenësh,

që për karrigen e vet janë gati të shesin në treg jo vetëm çamët dhe Çamërinë, por edhe identitetin e kombit shqiptar". Ish-kryeministri i ka bërë këto akuza

nisur nga informacionet e marra nga pala greke dhe transmetuar në median greke, e cila këto ditë ka qenë mjaft e ndjeshme për bisedimet mes dy vendeve.

AKUZA

"Me këtë akt të paimagjinueshëm Rama dhe Ditziu i tij kanë tejkaluar edhe masakrat e Zervës dhe barbaritë e Enver Hoxhës ndaj popullatës të martirizuar të Çamërisë dhe dheut shekullor të saj. Edi Rama dhe Ditziu i tij kanë shkëlmuar mbi gjakun, vuajtjen, sakrificat mbinjerëzore të çamëve, kontributin e tyre të pavdekshëm".



Presidenti i KE, Jean Claude Juncker dhe kryeministri Edi Rama gjatë takimit të djeshëm

Negociatat



SHPËTIM IDRIZI

"Deti, toka, varrezat, Çamëria nuk negociohen, por zgjidhen me dinjitet. Haram u qoftë shqiptarëve nëse e shohin Europën e Perëndimin nga Athina! Çamëria është makthi i kokave të shtrembra të Greqisë që ndërsa flasin për prindërit tanë si bashkëpunëtorë e kanë Agimin e Artë, nazistët e tyre në parlamentin e Greqisë", -tha kreu i PDIU-së.

"Organizatorët kishin lehtësira për të protestuar kundër qeverisë greke"

Protesta e çamëve në Tiranë, mediat greke: Barazuan politikanët me nazistët

Shoqata 'Çamëria', Partia Drejtësi Integrim, por edhe përfaqësues të republikës së vetëshpallur në Maqedoni "Ilirida" kanë protestuar para dy ditësh para ambasadës greke në Tiranë kundër marrëveshjes Shqipëri-Greqi që lidhje me emrin "Çamëri". Por ngjarja nuk ka mbetur pa u raportuar edhe në mediat greke. "Shqiptarët po mundohen me çdo mënyrë të vendosin Çamërinë në temën e bisedimeve mes dy ministriave të Jashtëm të dy vendeve. Këtë herë ata u përpoqën të bëjnë diçka ndryshe, u mblodhën jashtë ambasadës greke në Tiranë për të protestuar. Ata madje i kërkuan Greqisë të kërkojë falje për gjenocidin e shkaktuar ndaj çamëve", shkruan ProtoThema. "Çamët në protestën e zhvilluar në Tiranë, i barazuan politikanët grekë me Joseph Gaibels (politikan nazist në kohën e Hitlerit)", - shkruan media tjetër greke ANTI. Protesta përballë ambasadës greke e organizuar nga shoqata "Çamëria", dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, ka alarmuar mediat fqinje të cilat i kanë kushtu-

PROTESTAT

"Shqiptarët po mundohen me çdo mënyrë të vendosin Çamërinë në temën e bisedimeve mes dy ministriave të Jashtëm të dy vendeve. Këtë herë ata u përpoqën të bëjnë diçka ndryshe, u mblodhën jashtë ambasadës greke në Tiranë për të protestuar".

ar hapësirën kryesore të edicioneve informative. Tubimi në Tiranë kundër marrëveshjes Shqipëri-Greqi, që sipas protestuesve fshinë emrin "Çamëri", është pasqyruar dhe komentuar në "Prototema", "Tv Antena 1", "Elefterotipia", kathimerini, etj. "Protesta e çamëve u zhvillua para ambasadës greke me parullën kryesore: "Nuk fshihet emri Çamëri,

është çështje e të Drejtave të Evropës ...". Organizatorët kishin lehtësira nga ana e shtetit për të protestuar kundër qeverisë greke duke e detyruar të kërkojë falje dhe kthimin e pronave të tyre. Ata mbanin një tabelë me fotografi të politikanëve grekë dhe nazistë, duke barazuar edhe ministrin e Jashtëm grek Nikos Kotzias me Goebbels. Të



Faksimile e një prej mediave greke për protesta e çamëve në Tiranë

tjerë thërrisnin se çamët janë viktimë të gjenocidit, të tjerët thërrisnin sloganin: "Çamëria është Shqipëri" dhe një nga organizatorët e demonstratës bërtiti që "çamët janë si çifutët për Hitlerin: pa shtetësi dhe pa varret e paraardhësve", nënvizon Tv Antena 1 në edicionin qendror të lajmeve.



Darina Tanushi

Presidenti i Komisionit European, Jean-Claude Juncker, shoqëruar edhe nga komisioneri i zgjerimit Johannes Hahn deklaroi dje, në Tiranë se sheh një progres mbresëlënës nga Shqipëria, por ai kërkoi që deri në dhënien e rekomandimit të zgjidhë problemet me Greqinë. Pas pritisjes ceremoniale, që ju bë para Kryeministrit, Juncker e Rama dolën në një konferencë të përbashkët. Të dy delegacionet darkuan së bashku, por burimet bëjnë me dije se nuk ka pasur përfaqësues nga opozita shqiptare. Kryeministri shqiptar përsëriti faktin se Shqipëria i meriton negociatat, por pret një rekomandim të qartë dhe të pastër nga Komisioni Evropian, ndërsa për çështjet me Greqinë ai shprehu besim se do të zgjidhen më së miri. "E informova Presidentin se sot që flasim, ne numërojmë plot 17 prokurorë dhe gjykatës të niveleve më të larta të gjyqësorit shqiptar, që janë tërhequr nga procesi i vetingut, pra, që faktikisht nuk do të jenë më pjesë e sistemit gjyqësor, një tregues i qartë që vetingu ka filluar të funksionojë, si një shtysë e fuqishme drejt realizimit të objektivit të një sistemi drejtësie të re dhe të pavarur", -tha Rama, gjatë konferencës për shtyp. "Ka hyrë po ashtu në proces një transformim rrënjësor në marrëdhëniet e drejtësisë me qytetarët, në radhë të parë, përmes ndryshimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe çeljes së një sërë dosjeve që prej kohësh flinin në prokurori", -u shpreh ai më tej. "Vendosmëria jonë mbetet e palëkundur, sepse vetëdija jonë është që reformat e integrimi nuk janë të domosdoshme se na i kërkon Brukseli, nuk janë të detyrueshme, sepse na i kërkon Brukseli, por janë të domosdoshme dhe të detyrueshme, sepse i kërkon Shqipëria dhe është borxhi që i kemi gjeneratës tjetër. Ky është një proces unik, i pazëvendësueshëm për shtetbërjen dhe për funksionimin e institucioneve demokratike, këtu në vendin tonë. Për ne, integrimi në Bashkimin European nuk është një udhëtim për të shkuar gjatë, por është një përpjekje për të ndërtuar Shqipërinë europiane, këtu në vendin tonë", -theksoi kryeministri. "Besoj fort se e meritojmë rekomandimin e plotë dhe të pastër nga ana e Komisionit European dhe shpresojmë se edhe vendet anëtare do t'i përgjigjen pozitivisht, në unanimitet, kërkesës së KE-së, pasi i kemi kryer me përpikëri detyrat e shtëpisë për këtë fazë dhe çelja e negociatave përbën për ne, çeljen e një

Kreu i KE-së në Tiranë, darkë me kryeministrin, sot në mesditë takon Metën

Juncker: Zgjidhni çështjet me Greqinë Rama: Duam rekomandim të qartë

Pakti detar, Rama: Kam besim se Presidenti do bëjë detyrën



DITMIR BUSHATI

Në një status në "Twitter", Bushati shkroi dje, se "Moti është i stuhishëm, por mirëseardhje e ngrohtë në Shqipëri për Juncker dhe Hahn. 2018 është një ditë e vërtetë e mundësisë për Shqipërinë që të përparojë në rrugën drejt BE-së".

TAKIMI ME VLAHUTIN

Gjatë ceremonisë në kryeministri, dy zyrtarët e lartë të KE-së u shoqëruan nga shefja e BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin. Sapo ka hyrë në hollin e qeverisë Juncker i ka puthur dorën shefes së misionit, ndërsa ka përshëndetur ushtarakisht ministrin shqiptar Bushati.

DYSHIMET



Negociatorët, kush janë emrat që i janë dërguar Presidentit

Pas deklaratës së bërë nga kryeministri Edi Rama se tashmë sqarimet që kërkoi, Presidenti Meta i ka mbi tryezë qarulluan edhe emrat e negociatorëve. Sipas syri.net, në "ekipin negociator" të fshehtë dhe antikush-tetues" bëjnë pjesë individë me "integritet të dyshimtë" dhe që janë përzgjedhur nga Rama për të ruajtur "sekretet e negociimit" brenda "barikut të Shënmerisë", pra brenda një rrethi të ngushtë miqsh e shokësh me lidhje të forta nepotike, të largëta nga regjimi i vjetër, e ndoshta deri antishqiptare". Kështu përmenden emrat e Artur Meçollari, ish-shefit të kabinetit të Ditmir Bushatit, Pirro Vengu si edhe Qirjako Qirko, ambasador aktual i Shqipërisë në Britaninë e Madhe. Qirjako Qirko njihet si një personazh i "preferuar" nga pala greke, dhe për më tepër për momentin nuk ka asnjë pozicion që të justifikojë prezencën e tij në ekipin negociator.

BATUTAT E JUNCKER: "FALEMINDERIT, POR JAM I URITUR"

Presidenti i KE, Jean Claude Juncker shkëmbu batuta me kreun e qeverisë shqiptare, duke krijuar një klimë mjaft miqësore.

Edi Rama: Keqardhje që me gjithë përpjekjen që bëmë nuk arritëm dot t'ju presim me një kohë tipikisht shqiptare dhe mesdhetare, megjithatë është një mënyrë për t'u bërë në ndihën njësoj si në Bruksel: 'Shi, gri, mëzri'.

Jean Claude Juncker: Kam ardhur në Tiranë për t'i shpëtuar shirave të Brukselit, por më duket se po gjej përsëri klimën e Brukselit. Është një moment i vogël i një cikli shqiptar.

Në fund të konferencës, Juncker tha se ishte i uritur.

"Faleminderit shumë! Por jam i uritur" -tha Juncker, duke shkaktuar të qeshura e duke lajmëruar se do darkonte me Ramën.

kapitulli të ri përpjekjesh në rrugën e reformave drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin European", -theksoi Rama.

KREU I KE

Nga ana e tij, Presidenti i KE-së, Jean-Claude Juncker tha: "Ballkani Perëndimor dhe Shqipëria, veçanërisht, janë vende miq, aleatë dhe partnerë që kanë një perspektivë europiane, sepse Shqipëria është një vend thellësisht europian, por ne jemi ndarë nga historia, nga të papriturat e historisë për një kohë të gjatë, por tashmë nuk duhet humbur kaq shumë kohë sa na është dashur për t'u ndarë". "Konstatohet me kënaqësi që Shqipëria nuk pushon së akumulari progrese, sepse ka marrë shumë reforma strukturore në shumë fusha në

jetën tuaj kombëtare, të cilat janë impresionante. Edhe këto progrese janë mbresëlënëse. Nëse këto vazhdojnë në këtë rrugë reformash, kjo do t'i lejojë Shqipërisë që Komisioni European të rekomandojë hapjen e negociatave", -tha Juncker. Sa i përket një date për hapjen e negociatave, Juncker tha: "Nuk kam ardhur në Tiranë për të bërë premtime bosh. Është shumë e lehtë që për të dhënë kënaqësi, t'ju them në këtë datë apo në atë datë do fillojmë negociatat, por nuk është ky qëllimi im. Por vetëm mund të inkurajoj Shqipërinë që të vazhdojë reformat e rëndësishme, që janë ndërmarrë sidomos në luftën kundër korrupsionit, vetingut, organizimit të gjykatave. Ne do jemi përkrah Shqipërisë për ta ndihmuar të përgatisë

anëtarësimin. Në mënyrë që vende të tjera të bashkohen me Bashkimin European do të na duhet që të gjitha problemet, grindjet ndërmjet vendeve kufitare të jenë të zgjidhura deri në datën e anëtarësimit. Unë vetëm mund të inkurajoj atë që Shqipëria kërkon t'i japë fund konflikteve territoriale, sepse kjo është një provë për angazhimin e Shqipërisë për t'u bërë sa më shpejt anëtare e BE. Deri atëherë, ne e mbështesim Shqipërinë në të gjitha përpjekjet, edhe në përmirësimin e marrëdhënieve me vendet e Ballkanit Perëndimor", -theksoi Juncker. Ai rikonfirmoi se "vendi natyrisht i Shqipërisë është në gjirin e Bashkimit European".

NEGOCIATAT ME GREQINË

I pyetur në lidhje me ngërçin e krijuar mes qeverisë dhe Presidentit Ilir Meta për dhënien e autorizimit për negociatat me Greqinë, Rama u shpreh para gazetarëve: "Presidenti nuk e ka refuzuar dhënien e autorizimit, por Presidenti ka kërkuar me të drejtën që i jep Kushtetuta dhe autoriteti i tij disa sqarime të shkruara lidhur me kërkesën e dërguar për marrjen e autorizimit. Sqarimet e shkruara janë dhënë, janë në tryezën e Presidentit". "Kam besim dhe nuk kam arsye pse të mos kem, që Presidenti do bëjë detyrën dhe ne do të kemi gjithë kohën e nevojshme për të përmbushur këtë objektiv strategjik të zgjidhjes së të gjithë problemeve të mbartura me fqinj tonë jugor, janë probleme që shtrihen në 70 vite, të nënshkruar të një marrëveshjeje të re, që për ne duhet të jetë i bazuar fund e krye tek vendimi i Gjykatës sonë Kushtetuese", -tha Rama. Nga ana e tij, Presidenti i KE-së,

Juncker tha: "Ka të bëjë me problemet që mund të ekzistojnë ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë. Jam i mendimit se ato duhen zgjidhur sa më shpejt të jetë e mundur". "Jam i bindur që vendet e rajonit, që kanë konflikte territoriale, do të përpigjen t'i kapërcejnë ato dhe këto nuk mund të bëhen pas anëtarësimit. Zgjidhja e tyre duhet të bëhet para anëtarësimit. Pra, dua t'i inkurajoj ato, si Shqipërinë edhe Greqinë, të bien dakord e ky është një element plus për të pranuar hapjen e negociatave kur të vijë momenti", -tha ai. Sipas Juncker, "Kur Shqipëria të ketë në një mënyrë definitive, të ketë plotësuar të gjithë progresin që presim prej asaj dhe që për ato nga vetvetja, anëtarësimi do të jetë diçka e kryer". Ai sqaroi se nuk është thënë se Mali i Zi e Serbia mund të anëtarësohen në 2025, pasi kjo do të varet nga negociatat me Greqinë, Rama u shpreh para gazetarëve: "Presidenti nuk e ka refuzuar dhënien e autorizimit, por Presidenti ka kërkuar me të drejtën që i jep Kushtetuta dhe autoriteti i tij disa sqarime të shkruara lidhur me kërkesën e dërguar për marrjen e autorizimit. Sqarimet e shkruara janë dhënë, janë në tryezën e Presidentit". "Kam besim dhe nuk kam arsye pse të mos kem, që Presidenti do bëjë detyrën dhe ne do të kemi gjithë kohën e nevojshme për të përmbushur këtë objektiv strategjik të zgjidhjes së të gjithë problemeve të mbartura me fqinj tonë jugor, janë probleme që shtrihen në 70 vite, të nënshkruar të një marrëveshjeje të re, që për ne duhet të jetë i bazuar fund e krye tek vendimi i Gjykatës sonë Kushtetuese", -tha Rama. Nga ana e tij, Presidenti i KE-së,

VETINGU

Në lidhje me proceset hetimore që janë hapur në Shqipëri dhe procesin e vetingut, Presidenti i KE-së u shpreh: "Sa për vetingun, konstatohet se procesi është duke u zhvilluar dhe po jep rezultate mbresëlënëse. Ajo që do të donim dhe ne jemi të sigurve nga ato që na tha kryeministri, ky proces vetingu do të vazhdojë dhe përtej muajit prill, kur Komisioni do të botojë materialin në lidhje me shtetet kandidatë për anëtarësimin në BE". "I takon drejtësisë shqiptare të bëjë punën e saj dhe besoj që drejtësia shqiptare do ta bëjë punën e saj. Nuk më takon mua të them kush është fajtor e kush nuk është. Ka një sistem gjyqësor që funksionon gjithnjë e më mirë në Shqipëri dhe ky sistem është mjaft i fortë për të zgjidhur rastet që ju përmendni".

NDIHMA EKONOMIKE PERPLASJA

Replika mes kryeministrit e kreut të PD-së, për familjet në nevojë

Ndihma sociale, Rama: Jo, për ata që mund të punojnë. Basha: S'ka punë

Kreu i opozitës: "Të pushojmë nga puna këtë parazit"

Kryeministri Edi Rama dhe kreu i PD-së, Lulzim Basha replikuan dje, sërish në distancë në lidhje me ndihmën sociale për familjarët e pa punë. Kreu i qeverisë ka theksuar se nuk do të ketë ndihmë ekonomike për personat që janë të aftë për punë, teksa paralajmëroi se ata që janë hequr padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike do të riintegrohen. Mesazhi i kreut të qeverisë erdhi gjatë një vizite në familjen e Samiut në zonën e Urës Vajgurore, e cila më parë përfitonte 25 mijë lekë të vjetra nga skema e ndihmës ekonomike, por pas rivlerësimit të bërë me skemën e re, familja në fjalë merr skemë ekonomike të plotë. Kryeministri Edi Rama tha se falë skemës së re janë larguar nga përfitimti i ndihmës ekonomike familje që kishin në posedim vila disa katëshe apo makina luksoze. "Ja, kjo familje, (duke treguar foton), me vilë, me pretendimin se shtëpia është e vëllait ka përfutur ndihmë ekonomike. Shtëpia ka edhe panele diellore dhe ky zotëria përfitonte prej tre vitesh ndihmë ekonomike. Ne kemi vlerësuar dhe monitoruar çdo detaj, duke futur disa institucione në këtë proces, si Zyrenë e Regjistrimit të Pasurive, zyrenë e punësimit...etj", vijoi Rama. "Nga Berati janë përjashtuar 700 familje, ku pjesa më e madhe janë abuzivë. Ka një pjesë minimale, që po verifikohet, pasi ka dhe marzhin e saj të gabimit sistemi kompjuterik i pikëzimit, por këto familje që mund ta kenë pësuar për shkak të sistemit do riintegrohen".



Kreu i qeverisë Edi Rama gjatë një vizite në familjen e Samiut në zonën e Urës Vajgurore

Paloka: Rama i pafytyrë, shqiptarët të mos trajtohen si indianë

Nënkryetari i Partisë Demokratike Edi Paloka e cilëson kryeministrin Edi Rama si të pafytyrë, që ju tregoi mijëra familjeve në mjerim, rrugën e largimit nga vendi si "zgjidhje" të problemit të tyre. "I pafytyri, që jo më larg se dje iu tregoi mijëra familjeve në mjerim, rrugën e largimit nga vendi si "zgjidhje" të problemit të tyre, ka gjetur një zbatim të re e cinike. Çdo mëngjes ju paraqet shqiptarëve tituj gazetash apo reportazhe mediash të huaja që flasin për Shqipërinë virtuale të Ramës", -tha dje, Paloka. "Një kryeministër që ka larguar tanimë rreth 400 mijë shqiptarë nga vendi e tallet duke paguar po me paratë e shqiptarëve, reportazhe ku flitet për dyndje të italianëve drejt Shqipërisë "Amerika e re..." Është e vërtetë që Rama dhe shpura e tij kanë gjetur El Dorado-n, po shqiptarët nuk mund të nuk duhet të pranojnë të trajtohen si indianët e Amerikës nga këta konkuisatorë të popullit të tyre", -tha Paloka.

motivim këta persona të futen në punë. Ka fabrika këtu afër që kërkojnë punonjës. Zyra e Punës do jetë ndërmjetësuese", -nënvizoi kryeministri Edi Rama. Ndërsa, nga ana e tij, kreu i PD-së, Lulzim Basha u shpreh dje, duke marrë po një rast nga Berati. "Skamja në familjen Xhema në Be-

Zv. kryeministria e ministria e Drejtësisë inspektojnë Hipotekën e Beratit

Gjonaj: Masa disiplinore për ata që abuzojnë në kurriz të qytetarëve

Zv.kryeministria Senida Mesli dhe ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj kërkuar nga administrata që shërbimi ndaj qytetarit të jetë prioritet kryesor në çdo institucion. "Rishikimi i titujve të pronësisë për ato zona, të cilat preken nga projekte strategjike, apo të një rëndësie kombëtare duhet të shihen me përparësi të veçantë", -tha në një takim me punonjës të hipotekës në Berat, ministria Gjonaj. Nga ana tjetër ministria kërkoi që në kuadër të jetësisë të reformës në drejtësi dhe procesit të vetingut nuk do të tolerohet asnjë vonesë për informacionin e kërkuar nga organet e vetingut apo rivlerësimit kalimtar, kombëtar apo ndërkombëtar në këto



zyra. Duke iu drejtuar stafit të pranishëm Gjonaj sqaroi se për çdo rast abuzimi në kurriz të qytetarëve apo akt korruptiv të konstatuar do të ndërmerren menjëherë masa disiplinore, si dhe do të referohet kallëzim penal në prokurori për çdo punonjës apo drejtues sa herë të ketë indice për konsumim të veprës penale. Nga ana tjetër në secili prej institucioneve

Artani i kanë hequr bukën e fëmijëve, sepse ka punuar! Askush nuk e beson Edi Ramën se 20 mijë familje të përjashtuara nga ndihma zgjedhin 50 mijë lekë ndihmë në vend të punësimit dhe një status në "FB", Basha. "E vërteta është se punë nuk ka, se në krye të qever-

isë është punësuar një parazit që ka ndërthur skemën më të madhe të mashtrimit dhe vjedhjes së shqiptarëve. Është detyra e të gjithëve në që ta pushojmë nga puna njeriun që çdo ditë e më shumë po varfëron njerëzit dhe shkatërron jetët e tyre", -theksoi kreu i PD-së.



Kreu i opozitës Lulzim Basha në një familje në Kamëz

INSPEKTIMI

Balla e Sejdini në Shirgjan: Investime në infrastrukturë

Kryetari i Grupit Parlamentar Taulant Balla, së bashku me deputetin Arben Kamami dhe kryetarin e Bashkisë Qazim Sejdimi ishin në fundjavë në zonën e Shirgjanit në Elbasan, ku folën me banorët për domosdoshmërinë e investimit në këtë aks rrugor, duke u njohur edhe me projektet e tyre. "Në tre projektet kryesore të investimit në zonat rurale, ky është projekti prioritar, i cili u shërben 20 mijë banorëve. Për më tepër, në këtë zonë janë 60 ha sera, prodhimet e të cilave duhet sa më shpejt të dalin në pikat e grumbullimit. Ky është një kantier prodhimi bujqësor, i cili e ka të domosdoshëm investimin për t'u lidhur me infrastrukturën rrugore", -tha Balla. Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, Qazim Sejdimi, theksoi se investimi në këtë rrugë i shërben jo thjesht lëvizjes, por mbi të gjitha prodhimeve të kësaj zone: "Ky është një premtim i kahershëm dhe nuk është thjesht të bëjmë një rrugë se do hyjë një makinë, por kjo ka të bëjë me prodhimet bujqësore, është hambari i Elbasanit. Problemi është që ne të llobojmë ta marrim këtë investim", -tha Sejdimi.



Ministrja e Mbrojtjes takon efektivet e këmbësorisë në Poshnje

Ushtarakët në test për të shkuar në misione, Xhaçka: Vlerësim sipas meritës

"Me rëndësi që ky të jetë një proces transparent"

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka u tha efektiveve të batalionit të tretë të këmbësorisë në Poshnje të Beratit se ushtarakët që do të marrin pjesë në misionet jashtë vendit, do të kalojnë në testim. Në vizitën e saj, gjatë dy ditëve të qëndrimit për mbledhjen e qeverisë në Berat, ministrja Xhaçka shoqërohej nga zëvendësministri Petro Koçi dhe komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani. Fillimisht ministrja Xhaçka falënderoi të gjithë efektivet e këtij batalioni për angazhimin dhe kontributin e tyre në përmblytjet e fudit, sidomos tani që Emergjencat Civile janë nën përgjegjësinë e institucionit që ajo drejton. "Dua të ndalem pak tek Emergjencat Civile që tashmë janë fushë përgjegjësie e Ministrisë së Mbrojtjes, sepse e kam parë kontributin, dedikimin, përkushtimin, profesionalizmin e gjithsecilit prej jush në ato operacione shumë të vështira në fillim të dhjetorit, kryesisht në zonën e Fierit dhe të Vlorës, por edhe këtu në Berat me punën e jashtëzakonshme që ka bërë gjithsecili prej jush për t'i ardhur në ndihmë atyre banorëve që vuanin pasojat e motit të keq", tha ministrja Xhaçka, e cila u shpreh se ishte në dijeni të vështirësive dhe nevojave të ushtarakëve dhe për të cilat shprehur angazhimin e saj për një trajtim më dinjitoz për secilin prej tyre. Më tej ministrja Xhaçka zhvilloi një bisedë të shkurtër edhe me ushtarakët që kanë kaluar me sukses testet për t'u bërë pjesë e kontingjentit të ardhshëm shqiptar, i cili do të shërbejë në misionin e NATO-s Resolute Support në Kabul të Afganistanit, në kuadër të rritjes së kontributit të vendit tonë dhe shtimit të trupave shqiptarë në këtë mision. Ministrja i siguroi ata për një proces përzgjedhës të rregullt, i bazuar tërësisht në meritë dhe për të cilin mori konfirmimin e tyre. "Është shumë e rëndësishme që ky të jetë një proces, i cili vlerëson më të mirët, që vlerëson meritokracinë dhe vlerëson ata njerëz që vërtetë janë të përgatitur për të shkuar në misione paqeruajtëse sepse sigurisht ju të gjithë e kuptoni që është një përgjegjësi jas-



Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka me efektivet e batalionit të tretë të këmbësorisë në Poshnje

Deklarata



XHAÇKA

"Vetëm ata që vërtet meritojnë, janë ata që do të shkojnë në mision dhe, kur them meritë, kam parasysh përgatitjen për këtë ditë. Dhe që ky mjedis të jetë më konkurrues dhe të promovojë realisht cilësinë dhe profesionalizmin, duhet të jeni të gjithë në garë me njeri - tjetrin", - tha Xhaçka.

Ministri i Shtetit për Diasporën në Gjermani: Së shpejti me një konventë

Majko: Votimi në zgjedhje, garanci e pamohueshme për shqiptarët jashtë vendit

Arsimi shqip në Gjermani, vendosja e standardeve të përbashkëta arsimore me Kosovën dhe problematika të komunitetit shqiptar atje, ishin mes çështjeve të diskutuara gjatë takimit që zhvilloi ministri Pandeli Majko me përfaqësues të shoqatave shqiptare në Dusseldorf. Ndër të tjerë, në takim ishin të pranishëm përfaqësues të shoqatave "Lidhja e arsimtarëve shqiptarë" e "Lidhja e shkrimtarëve". Arsimtarët e njohën ministrin me situatën e arsimit shqip në landin e Rinit Verior-Vestfali, ku siç thanë, në ato qytete ku mundësohet shkollimi shqip, pjesëmarrja e nxënësve është e konsiderueshme, por mund të ishte më e lartë. Përfaqësuesja e "Lidhjes së arsimtarëve shqiptarë" e



vuri theksin tek potenciali i brezit të ri në Gjermani që po mëson shqip dhe kërkoi më shumë bashkëpunim për krijimin e lehtësirave për ata. U diskutua për kurrikulën dhe rolin e teknologjisë në mësimin e gjuhës shqipe. Ministri i Shtetit për Diasporën prezantoi iniciati-

vat që po ndërmerr në këtë aspekt, si ato të librave online dhe krijimit të një rrjeti të profesionistëve në internet. Ai u ndal tek nevoja e standardizimit, duke kërkuar mbajtjen e një aktiviteti të përvitshëm të librit apo mbledhje të tjera që do të mundësonin komunikime e bashkëpunime të dobishme. Përpjekjet e Ministrisë dhe qeverisë për mundësimin e votimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, ishin një tjetër çështje për të cilën pati interes. "Ndërtimi i një strukture të përhershme për diasporën dhe mundësimi i votimit do të ofrojnë një garanci të pamohueshme për shqiptarët jashtë vendit", -tha Majko. Ministri foli edhe për përpjekjet që po bëhen për organizimin e një konvente për diasporën.



Kuvendi, deputetët diskutojnë vetingun në polici e kodin e tyre të sjelljes

Kuvendit pritet të diskutojë sot në seancë plenare projektligjin për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit e Gardës. Për këtë pikë pritet të ketë debate, pasi opozita nuk ka pranuar që ta kalojë me procedurë të përsheptuar. Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, ka miratuar rendin e ditës, ku, gjithashtu, pritet të diskutohen veç projektligjit për "Për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme" edhe kodi i sjelljes së deputetëve. Po ashtu, deputetët e Kuvendit do të zhvillojnë diskutime edhe mbi ratifikimin e traktatit që themelon Komunitetin e Transportit. Ndërkohë, pritet që deputetët të votojnë projektvendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri si dhe atë për propozimin Kuvendit të kandidatëve për kryetar të Komisionit të Prokurimit Publik.

htëzakonisht e madhe që merrni mbi vete, jo vetëm për t'i shërbyer vendit tonë, por edhe për të projektuar siguri atje ku shkoni. Që do të thotë mbronit të tjerët edhe mbronit veten dhe duhet të jeni maksimalisht të përgatitur për këtë moment dhe, prandaj insistoj që këto testimet, që ky moment vlerësimi të jetë sa më i hapur, sa më transparent edhe gjithsecili prej jush të jetë i qartë për vlerësimin

që merr dhe për vlerësimin që merr shoku juaj. Vetëm ata që vërtet meritojnë, janë ata që do të shkojnë në mision dhe kur them meritë, kam parasysh përgatitjen për këtë ditë. Dhe që ky mjedis të jetë më konkurrues dhe të promovojë realisht cilësinë dhe profesionalizmin, duhet të jeni të gjithë në garë me njeri - tjetrin", -tha Xhaçka. Më pas, ministrja Xhaçka ndoqi nga afër një

pjesë të programit mësimor teorik të ushtarakëve, në mjediset e një prej kabineve të këtij batalioni. Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura iu bashkuan nismës së Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit "Ditët e Pemëve", duke mbjellë pemë në oborrin e shkollës së mesme të bashkuar "Shyqyri Lakra" në Berat dhe në mjediset e batalionit të tretë të këmbësorisë në Poshnje.

Ambasadori i OBSE-së: Shitblerja e votës, të hetohen më shumë raste

Bochardt: Në zgjedhjet e 2019 me teknologji të re, depolitizim të procesit të numërimit

"Kemi filluar të trajnojmë zyrtarë zgjedhorë"

Ambasadori i OSBE-së, në Shqipëri Bernd Borchardt deklaroi dje, gjatë një interviste për Vizion Plus se për organizimin e zgjedhjeve të 2019 ka kohë që të aplikohet edhe teknologjia e re, por kjo kërkon shumë punë dhe prokurime të kushtueshme. Ai bën thirrje që çështja e shitblerjes së votës të hetohet me seriozitet.

Z. Ambasador, Komisioni i Reformës Zgjedhore ka nisur punën nga nëntori i vitit të kaluar. Në këndvështrimin tuaj, si është produkti i tij, si po vazhdon ecuria e këtij komisioni?

Pikësëpari, është vërtet e rëndësishme të theksohet se ne e mirëpresim ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore në një fazë shumë të hershme dhe faktin që tani ata janë vetëinstitucionalizuar dhe kanë hartuar një kalendar pune. Ky është një hap në drejtimin e duhur dhe ka mbetur ende pak kohë për të bërë ndryshime, reformime. Aspekti i dytë, që ne vlerësojmë, janë dëgjuesat me shoqëri të civilë. Kjo tregon që komisioni dëshiron ta bëjë procesin gjithëpërfshirës. Së treti, ne rekomandojmë që të përfshihet edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili ka fituar shumë përvojë.

Z. Ambasador, një ndër pikat e forta të diskutimit politik është edhe aplikimi i teknologjisë në zgjedhje: votimi dhe numërimi elektronik. Një vit më parë, në një intervistë për "Vizion Plus", ju thatë se në zgjedhjet politike të qershorit ishte e pamundur aplikimi i teknologjisë. A mendoni se ekziston koha e nevojshme për t'u përgatitur dhe për të përgatitur teknologjinë në zgjedhjet politike apo, pse jo, të bëhet një projekt pilot në zgjedhjet lokale për të kuptuar efektivitetin e këtij procesi?

Vitin e kaluar, debati për teknologji e reja të votimit filloi në një fazë shumë të vonë dhe ne paralajmëruam shumë qartë, edhe në emisionin tuaj, se mund të krijonte probleme të mëdha nëse politika shqiptare do të përploqej t'i fuste teknologjitë e reja brenda një kohe shumë të shkurtër. Tani ka kohë. E megjithatë, teknologjitë e reja të votimit janë sfidë e madhe, edhe pse kanë ngulur më shumë se tre vjet deri në zgjedhjet e ardhshme kombëtare. Një nga rekomandimet e forta të OSBE-së dhe ODIHR-it, si dhe praktikant më të mira ndërkombehtarë tregojnë se këto teknologji duhet që të testohen. Ju e dini, në vitin 2013 u bënë dy teste dhe që të dyja dështuan. Kështu që, pikësëpari, duhet të kemi provën që këto teknologji funksionojnë dhe cila prej tyre konkretisht. Zgjedhjet vendore të 2019-s do të ishin rast i mirë për këtë. Këto zgjedhje do të zhvillohen pas një viti e gjysmë, por duhen bërë disa prokurime të kushtueshme. Kjo kërkon kohë, nëse bëhet në mënyrë transparente. Pra, duhen marrë disa vendimeve. Përveç kësaj, duhen bërë edukimi i zgjedhësve. Zgjedhësi i zakonshëm është mësuar të vendosë një kryq në një fletë letre dhe shumë njerëz nuk janë nga ata që merren gjysmën e ditës me celularin, si fëmijët në autobus. Njerëzit duhet të njihen me mënyrën e re të votimit dhe kjo kërkon kohë. Pra, që përpara zgjedhjeve vendore, duhet bërë trajnimi i zgjedhësve. Pra, koha fluturon. Tani ka mbetur edhe një vit e gjysmë kohë. Unë do të nxitja një përshpejtim të procesit. Teknologjitë e reja të votimit kanë shumë aspekte. Unë kam rekomanduar tashmë publikisht që të shqyrtohet me kujdes numërimi elektronik. Një nga rekomandimet tona të forta ka qenë gjithmonë depolitizimi i administratës së zgjedhjeve dhe ndoshta numërimi elektronik do të kontribuonte në depolitizimin e procesit të numërimit. Dhe kjo nuk është edhe aq e kushtueshme. Aspekte të tjera, si teknologjitë e reja të votimit për identifikimin e zgjedhësve, mbartin disa rreze. A do të funksiononte? Kjo duhet testuar me hollësi. Si t'i kemi të dhënat që na duhen në qendrat e votimit? A do të funksiononte



Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, Bernd Borchardt

gjithmonë lidhja me internetin? A ekziston rreziku i ndërhyrjeve nga hakerat? Ajo që dua të them është se teknologjitë e reja të votimit duhet ta rrisin besimin të zgjedhjet dhe nuk duhet që, në kohën e hakerave dhe sulmeve kibernetike, ato ta ulin këtë besim të zgjedhjet.

Z. Ambasador, një tjetër moment i debatit politik është edhe votimi i shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit. A kemi ju një këshill ose, pse jo, edhe një model, tek i cili mund të bazohet politika shqiptare për t'ia arritur qëllimit të votimit të shqiptarëve jashtë atdheut?

Votimi jashtë vendit ngre dy çështje madhore. Njëra është çështja e sistemit zgjedhor, kurse tjetra është ajo e metodologjisë. Sa i përket sistemit zgjedhor, ka shembuj të shumtë. Unë vetë jam gjerman. Në vendim tim, unë mund të regjistrohem dhe kështu bëra në zgjedhjet e kaluara, në zonën zgjedhore ku jetoja së fundmi, në pjesën veriore të Berlinit dhe zona zgjedhore ma dërgoi këtu fletën e votimit. Vura kryqin dhe ua dërgova prapë. Kjo është njëra nga mënyrat e mundshme. Ka edhe mënyra të tjera. Ne organizuam dy konferenca, për teknologjitë e votimit dhe për votimin jashtë vendit, për t'i njohur vendimmarrësit shqiptarë me rreziqet dhe problemet e mundshme. Me sa e ndoqa diskutimin, ideja e realizimit të votimit jashtë vendit përmes internetit është identifikuar tashmë si jashtëzakonisht e vështirë. Ngaqë kjo do të shoqërohej me rreziqun e sulmeve nga hakerat dhe sulmet kibernetike dhe ngaqë është jashtëzakonisht e komplikuar ruajtja e fshehtësisë së votës. Prandaj, kjo zgjedhje është jashtëzakonisht e vështirë dhe kërkohet edhe përdorues që janë shumë të sofistikuar, që do të thotë punë e jashtëzakonisht trajnimi. Një tjetër opsion, i cili është edhe opsioni i preferuar në nivel ndërkombëtar, është votimi me postë. Ky është i mundur. Nuk ka rekomandime të OSBE-së apo ODIHR-it se si duhet të bëhet votimi për shtetasit që jetojnë jashtë vendit. Për këtë nuk ka as standarde ndërkombëtare, por ka përvoja që tregojnë se çfarë ka funksionuar, çfarë ka rezultuar

shumë e komplikuar, çfarë mund të bëhet më lehtë dhe votimi me postë është sigurisht diçka që mund të bëhet më lehtë. Një nga çështjet është se si mund të bëhet regjistrimi i zgjedhësve. Siç edhe sapo shpjegova shembullin tim, unë duhet të regjistrohesh sërish në zonën zgjedhore ku jetoja më parë në Berlin. Në vende të tjera ka modele të tjera. Pastaj, është edhe çështja se si përfaqësohen zgjedhësit jashtë vendit, në listat e zakonshme apo nga anëtarë të posaçëm të parlamentit që zgjidhen nga zgjedhësit jashtë vendit, i cili është gjithashtu, një tjetër model. Pra, është, diçka që duhet diskutuar gjërë e gjatë. Ne rekomandojmë që kjo të bëhet në një mënyrë të thjeshtë, në një mënyrë që kushdo ta kuptojë lehtë, përndryshe zgjedhësit që nuk janë të sofistikuar mund të frenohen e të mos votojnë.

Z. Ambasador, një tjetër pikë debati është edhe fakti i sistemit zgjedhor në Shqipëri. Ju e kemi ndjekur shumë procesin zgjedhor në vendin tonë. Si e konsideroni sistemin aktual dhe mendoni se mund të ketë hapësira për ta ndryshuar atë?

Ne dhe ODIHR-i kemi bërë disa rekomandime për disa ndryshime. Një shembull shumë i njohur është sugjerimi për ndryshimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor në lidhje me të ashtuquajturat "kasete" të gatshme që vijnë nga partitë në stacionet televizive dhe identifikimi shumë i qartë për shikuesit se ajo që po shohin nuk është gazetari, por produkt i një partie politike, ose heqja dorë nga transmetimi i tyre. Ne i përgëzuar ata që e bënë këtë, siç bëri RTSH-ja në zgjedhjet e fundit. Një tjetër aspekt është çështja e sistemit zgjedhor. Mes Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së ka një sërë sistemesh, kështu që ka shumë hapësira manovrimi për një vendimmarrje legjitime të aktorëve vendas, të pakicave kombëtare, e të një shumice të fortë të cilësuar në këtë rast. Unë e di se partitë e vogla janë veçanërisht kritike ndaj sistemit. Edhe në vende të tjera kritikohen sistemet nga partitë më të vogla. Megjithatë, kjo është një çështje për të

cilën duhet të vendosin aktorët vendas. Ajo çka ne mund të bëjmë është që me marrjen e një vendimi për sistemin zgjedhor, të këshillojmë se si mund të zbatohet ai vendim në praktikë në kuadrin e angazhimeve të OSBE-së.

Z. Ambasador, në raportin e fundit të OSBE/ODIHR-it theksohej edhe shitblerja e votës. Cili është opinion i juaj për këtë fakt?

Raporti trajtoi kryesisht perceptimin e shitblerjes së votës, gjë që beson besueshmërinë e zgjedhjeve. Dhe besueshmëria është një çështje thelbësore. Kështu që ai rekomandon ndërmarrjen e më shumë hapave për shmangien dhe luftën ndaj shitblerjes së votave, shpërdorimit të burimeve shtetërore dhe presioneve të lidhura me punësimin, pra kundër të gjitha llojeve të krimeve dhe mashtrimeve zgjedhore. Në fushën e shpërdorimit të burimeve dhe të presioneve, një rekomandim që mund të bëhet është ai i ngritjes së një Avokati Populli apo i një mekanizmi tjetër - rekomandimi ynë nuk bën ndonjë specifikim të posaçëm në mënyrë shumë të hollësishme - për mbikëqyrjen e procesit, përdorimin e këtyre burimeve gjatë fushatave zgjedhore. Pra, duhet të bëhet në një plan më afatgjatë ajo çka administruesit teknikë bëjnë gjatë zgjedhjeve të fundit. Një nga konstatimet e vlerësimit të tyre ishte se nuk patën kohë të mjaftueshme. Një nga rekomandimet që bën raporti i ODIHR-it për shitblerjen e votave është ashpërsimi i dënimeve penale, ndërkohë që rekomandim i fortë është gjasja më aktive e prokurorisë. Ka pasur një numër treshifror rastesh që i janë përcjellë prokurorisë. Me mbështetjen e Këshillit të Evropës u ngrit edhe një linjë telefonike falas, një portal, ku njerëzit mund të dërgojnë ankesa. Dhe ankesa ka pasur. Kjo nuk është diçka që është shpikur. Problemi ekziston. Se sa i madh është ky problem, askush nuk e di me të vërtetë. Megjithatë, problemi ekziston dhe ai mund të luftohet duke e frenuar përmes dënimesh më të ashpra dhe përmes shembujve të një ndjekjeje penale efektive dhe trajtimit të tij me seriozitet. Bëhet fjalë për një krim. Ne e kemi mirëpritur hapjen e çështjeve nga prokuroria në lidhje me shpërdorimin e burimeve shtetërore dhe unë kam theksuar disa herë publikisht se do ta donim shumë të shihnim edhe hapjen e çështjeve për shitblerjen e votës.

Zgjedhjet në Shqipëri administrohen nga partitë politike. Mendoni se ka ardhur momenti që proceset zgjedhore të administrohen nga nëpunës civilë, pra të kemi një depolitizim të gjithë hierarkisë së administrimit të zgjedhjeve?

Ne e kemi rekomanduar këtë shumë herë, pas zgjedhjeve të 2013-s, 2015-s dhe 2017-s. Pra, është rekomandim i përsëritur. Për shembull, një hap do të ishte numërimi elektronik, siç e shpjegova. Një tjetër hap për të cilin kemi filluar të punojmë, së bashku me miqtë tanë të Këshillit të Evropës dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është trajnimi i një grupi zyrtarësh zgjedhorë, në mënyrë që të ketë mundësi zgjedhjeje nga një grup më i madh zyrtarësh se sa nevojiten. Megjithatë, mbetet rekomandim i fortë ai i depolitizimit të të gjithë sistemit dhe vendosja e tij në duar të ekspertëve dhe jo të njerëzve të emëruar apo besnikë të partive të tyre.

Atentati në zonën e ish-Bllokut, zbulohen debatet e shkuara të 64-vjeçarit

Ekzekutimi i biznesmenit Begalla, dyshime se tjetërsonte e shiste pronat

Pista e hetimit: Konflikti me pronarët e tokave në Kashar dhe Mëzës

Të tjera detaje dalin në dritë, 11 ditë pas vrasjes së biznesmenit 64-vjeçar Afrim Begalla. Policia ka zbuluar se ai ka pasur konflikte të shumta me persona të ndryshëm.

Gjatë hetimeve zbulohen dy raste të reja, të cilat flasin për mashtrime të kryera nga biznesmeni i ekzekutuar me pistoletë me silenciator pranë shtëpisë së tij, në zonën e ish -Bllokut, nga këta dy persona që shfaqen në një kamera sigurie, të cilët nuk janë identifikuar ende. Burime nga grupi hetimor bënë të ditur për Tv Klan se prej vitit 2013 e në vazhdim Begalla kishte marrë në mirëbesim për qëllime biznesi sipërfaqe pronash në Kashar dhe Mëzës. Ai kishte premtuar partneritet në biznes për pronarët e tokave, por më pas dyshohet se i ka tjetërsuar ato, ose i ka shitur pa pëlqimin e të zotëve. Edhe paratë e fituara nga shitja, sipas hetuesve, Memli Begalla nuk i kishte ndarë me pronarët e tokave. Në këto kushte ata janë konfliktuar me tregtarin, duke kërkuar së paku një pjesë të tyre. Mirëpo edhe pas kësaj situate, borxhi nuk është shlyer dhe kjo ka sjelle konflikte të ashpra me disa prej pronarëve. Ata janë pyetur nga policia dhe kanë konfirmuar

këtë version, por kanë mohuar çdo lidhje me vrasjen. Hetuesit po vlerësojnë edhe një pistë që lidhet me mashtrimet në Zvicër. Në këtë vend Begalla, ka pasur marrëdhënie me disa tregtarë gomash, të cilëve u ka marrë produkte me premtimin për t'ua kryer pagesat pasi të shiteshin. Edhe në këtë rast ai nuk i ka kthyer paratë. Pavarësisht këtyre të dhënave, dy djemtë e Begallës, të ripytur nga policia, nuk kanë pranuar se i ati kishte pasur probleme me biznesin.

AUTORI I KRIMIT

Autori mësohet se ka qenë i veshur me një xhakë të bardhë, të mbërthyer deri në fyt, ndërsa në kokë mban një kapele duke mbuluar edhe fytyrën. Vrasësi është munduar gjatë gjithë kohës që të mbulohej për të mos u identifikuar nga



Viktima, Afrim Begalla

kamerat e sigurisë të bizneseve përreth. Nga kamerat e sigurisë dallohet personi që kreu vrasjen duke ecur me hapa të lehtë dhe pa rënë sy. Autorit nuk i dallohet fytyra për shkak të xhakës dhe kapelës që mban në

kokë. Pas krimit ai ecën në këmbë dhe më e pas ndihmon një makinë për t'u larguar nga vendi ku kreu vrasjen me silenciator.

VRASJA


Sipas burimeve pranë grupit hetimor, Memli Be-

PISTA E HETIMIT

Burime nga grupi hetimor bënë të ditur se prej vitit 2013 e në vazhdim Begalla kishte marrë në mirëbesim për qëllime biznesi sipërfaqe pronash në Kashar dhe Mëzës. Ai kishte premtuar partneritet në biznes për pronarët e tokave, por më pas dyshohet se i ka tjetërsuar ato, ose i ka shitur pa pëlqimin e të zotëve. Edhe paratë e fituara nga shitja, Memli Begalla nuk i kishte ndarë me pronarët e tokave.

galla që kishte aktivitet në fushën e turizmit, energjetikës, ndërimit dhe importeksport të industrisë ushqimore është qëlluar sapo ka dalë nga automjeti i tij. 64-vjeçari është qëlluar disa herë nga autorët dhe për pa-

sojë ka mbetur i vdekur në vend. Burimet e mësipërme pohuan se autorët e kanë ndjekur biznesmenin me një makinë tip "BMW" me ngjyrë të zezë dhe me xham të zinj dhe pasi kanë qëlluar mbi objektivin janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Ndërkaq, dyshohet se viktima i ka pikasur autorët dhe ka dalë nga makina e tij për të shpëtuar. Gjatë këqyrjes së trupit të pajetë është konstatuar se një nga plumbat e ka kapur në kokë Memli Begallën. "Më 14 shkurt rreth orës 21:00, në Sallën Operative ka ardhur një telefonatë se në rrugën "Nikolla Tupë", në sheshin mes pallateve një shtetas ndodhet i shtrirë në tokë. Menjëherë në vendngjarje kanë mbërritur shërbimet e policisë dhe ambulanca ku nga veprimet paraprake ka rezultuar se është vrarë me armë zjarri shtetasi M.B., rreth 64 vjeç. Është ngritur një grup i posaçëm hetimor dhe janë ngritur pika kontrolli në disa akse rrugore. Policia ka shoqëruar disa persona që mund të kenë dijeni për rrethanat e hetimit. Po punohet për sigurimin e provave të vlefshme për sgarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe zbardhjen e autorësisë së saj", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.



REPUBLICA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikes dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit".

I - Rishpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e "Përkthyesit"

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip.
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombetare.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për tu pajisur me Çertifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 Mars deri më 16 Mars 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë".** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës **16 Mars 2018**, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike** nga data **12 Mars deri më 16 Mars 2018** në adresën: **info@kpa.al**. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëdhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të notizuara. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njohësimin e diplomave, sipas legjisllacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore no fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

36-vjeçarja jashtë rrezikut për jetën në spitalin e Durrësit

Humbi burrin dhe 3 fëmijët, Evisa Preka mëson të vërtetën tragjike

Ditën e djeshme Evisa Preka është njohur me lajmin e kobshëm për vdekjen e burrit dhe të tre fëmijëve. Një javë pas aksidentit tragjik në Velipojë që mori jetën e 4 pjesëtarëve të familjes Preka, nëna e tre fëmijëve ka marrë vesh lajmin e hidhur. Evisa ishte e vetmja që i mbijetoi aksidentit, ku bashkëshorti i saj, Edmondi, dhe tre fëmijët e vegjël, djali 9 muajsh Rajan, dhe dy vajzat Noem e Ajsel, 10 e 5 vjeçe, humbën tragjikisht jetën. Kanë qenë mjekët e spitalit, të cilët i kanë dhënë lajmin guas, gjendja e së cilës është rënduar edhe më shumë, kur është njohur me tragjedinë. Mësohet se 36-vjeçarja është shokuar nga lajmi i hidhur dhe ka shpërthyer në lot e britma në spital, ndërsa mjekët kanë vepruar menjëherë, duke i bërë qetësues për ta vënë në gjumë. Evisa Preka tashmë ende ndodhet nën efektin e ilaçeve dhe një kujdes të rreptë të mjekëve të spitalit të Durrësit. Gjendja e saj shëndetësore është jashtë rrezikut për jetën, ndërsa ka disa dëmtime në fytyrë dhe pjesë të tjerat të

mbremjen e 18 shkurtit, ku makina "Alfa Romeo" me të cilën udhëtonin u përplas me një makinë tip "Fuoris-tradë", përplasje që rezultoi fatale për katër pjesëtarët e familjes. Nga aksidenti mbetën të plagosur dhe dy të rinj, të cilët ndodheshin në mjetin tjetër.

Shoqëria Përbarimore "AFA-2010" sh.p.k
shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.7/156 e llojit "Trull + Ndërtësi", e ndodhur në ZK.2693, Milot Laç, Kurbën, në pronësi të H.Shabani, Vënë në hipotekë për shumën 7,660,000 lekë. Çmimi fillestar në ankand është 5,600,000 Lekë.

Ankandi zhvillohet në datë **02.03.2018, ditën e Premte ora 15.30** në ambientin e Shoqërisë Përbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delivina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info: <tel:044503458> ose E-maili shogeriapërbarimoreafa2010@gmail.com

Shembuj konkretë të përcaktimit të masës së përfitimit, bazuar në pagën që ka pasur individ

Voltiza Duro


Tabela, ja sa janë koeficientët për llogaritjen e pensioneve

Formula ku duhet të bazoheni për të mos gabuar

J o pak individë që marrin pension shpesh herë janë të paqartë në lidhje me përlogaritjen e masës e kërkojnë përgjigje nga ekspertët e fushës së sigurimeve shoqërore. Sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", pensioni i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe një shtesë dhe pagat e individëve që kanë derdhur kontribute shumëzohen me koeficientin përkatës, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. "Gazeta Shqiptare" publikon sot koeficientët e indeksimit të pagave që prej vitit 1994 deri në vitin 2015. Sipas vendimit të botuar në Fletoren Zyrtare, në vitin 2015 dhe në vazhdim, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, pas indeksimit të tyre vit pas viti, me koeficientët vjetorë të përcaktuar, nuk mund të jenë më të larta se trefishi i pagës minimale të indeksuar, të vitit përkatës, për pagat nga viti 1994 deri në 31.12.2001 apo më të larta se paga maksimale, e përcaktuar për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2014 e në vazhdim, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim. "Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2015 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 582, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet, vetëm për pensionet me datë fillimi deri në 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë.", nënvizohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

PËRLOGARITJA ME FORMULË

Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pensioni i Pleqërisë) = PS (Pension Social)* (shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet + 1/100* (shumëzuar) vite sigurimi* BV (baza e vlerësuar). Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të peri-



Faksimile e vendimit të Këshillit të Ministrave mbi koeficientët e indeksimit të pagave



Foto ilustruese

KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

➔ Për pagat referuese, deri më 1.1.1994	8.59
➔ Për pagat e vitit 1994	8.59
➔ Për pagat e vitit 1995	6.92
➔ Për pagat e vitit 1996	5.37
➔ Për pagat e vitit 1997	5.37
➔ Për pagat e vitit 1998	4.48
➔ Për pagat e vitit 1999	3.64
➔ Për pagat e vitit 2000	3.31
➔ Për pagat e vitit 2001	2.83
➔ Për pagat e vitit 2002	2.62
➔ Për pagat e vitit 2003	2.34
➔ Për pagat e vitit 2004	2.13
➔ Për pagat e vitit 2005	1.96
➔ Për pagat e vitit 2006	1.73
➔ Për pagat e vitit 2007	1.67
➔ Për pagat e vitit 2008	1.48
➔ Për pagat e vitit 2009	1.36
➔ Për pagat e vitit 2010	1.30
➔ Për pagat e vitit 2011	1.25
➔ Për pagat e vitit 2012	1.20
➔ Për pagat e vitit 2013	1.16
➔ Për pagat e vitit 2014	1.00

udhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit, si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve sh-

tetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikaistiv aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si dhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me

pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59.

SHËMBUJ KONKRETË

Po të marrim një pagë referuese për një specialist të lartë në ndërmarrje ekonomike, që aktualisht është e miratuar në masën 4,192 lekë, duke e shumëzuar me koeficientin 8.59, e indeksuar deri në periudhën aktuale jep një pagë prej 36,009 lekë. Ndërsa mbas vitit 1994, merren pagat respektive sipas viteve, të cilat duke u shumëzuar me koeficientët përkatës, japin pagën për efekt të llogaritjes së pensionit. Po të marrim një rast konkret; në vitin 2008, paga minimale ka qenë 14,830 lekë, duke u shumëzuar me koeficientin e indeksimit (i cili miratohet çdo vit me VKM), që është 1.48 jep pagën minimale prej 22000 lekë. Po kështu, edhe paga maksimale, e cila ka qenë 74 150, kur shumëzohet me po këtë koeficient indeksimi, jep pagën maksimale aktuale 97,030.

Në rastin e mësipërm, në qoftë se, ky person ka punuar mbi moshë për një periudhë prej 1 viti e 6 muaj, shtesa mbi pension do të llogaritet, 18 muaj * 0.5 = 9% * 17 356 = 1 562 lekë. Në këto kushte pensioni që do të përfitonte aplikuesi do të ishte i barabartë me shumën 17 356 + 1562 = 18 918 lekë. Krahas pensionit të plotë, personat e interesuar kanë mundësi të përfitojnë dhe pension të reduktuar. Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92 kur kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92; dhe nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar.

LLOGARITJA

Në vitin 2008, paga minimale ka qenë 14,830 lekë, duke u shumëzuar me koeficientin e indeksimit (i cili miratohet çdo vit me VKM), që është 1.48 jep pagën minimale prej 22000 lekë. Po kështu, edhe paga maksimale, e cila ka qenë 74 150, kur shumëzohet me po këtë koeficient indeksimi, jep pagën maksimale aktuale 97,030.



Të moshuarit mbjellin 10 pemë në liqenin artificial

Të moshuarit e shtëpisë së të moshuarve të "Ali Demi", së bashku me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, mbollën 10 pemë mimosazh pranë "Debatikut", në parkun e madh të liqenit artificial. "Shumë herë njerëzit thonë: po mirë, gjithë këto pemë, vetëm të pasurit kontribuojnë? Por, e vërteta është krejt ndryshe: janë kryesisht njerëzit e thjeshtë; ata që kanë më pak, japin më shumë. Sot i jemi mirënjohës çdo kompanie që ka dhuruar pemë, po kur mendon që shtëpia e të moshuarve na jep 10 mimozha, pra gjithçka që kishte, na bën të kuptojmë se bujaria, zemërgjerësia, dashuria, nuk varet nga sa ke, por nga sa do të japësh". - tha kryebashkiaku Veliaj.



Epidemia e fruthit, 163 të prekur në total, 75% fëmijë

Autoritetet shëndetësore janë në alarm pasi epidemia e fruthit po vazhdon të shënojë rritje. 163 persona janë infektuar që prej fillimit të janarit, 115 prej të cilëve janë në kryeqytet. Ekspertët e Shëndetit Publik thonë se 75% janë fëmijë, ndërsa pjesa tjetër i përkasin të lindurve në vitet '80-'90. Deri më tani nga fruthi kanë mbetur jetën dy fëmijë nën 1 vjeç si pasojë e komplikacioneve të shkaktuara prej saj. Për të parandaluar përhapjen e epidemisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale ka ngritur dhe komitetin e eliminimit të fruthit. Nga Morava e Beratit, ministria e Shëndetësisë Ogerta Manastirliu e ka vënë theksin tek vaksina kundër fruthit, e cila po injektohet në grupet e riskut për të frenuar përhapjen masive të epidemisë.

LONDER- Policia angleze ka vënë në pranga ditën e djeshme tre autorët e vrasjes së shqiptarit Jozef Boci. Ngjarja e rëndë ndodhi në orët e para të së shtunës së 17 shkurtit, në Greenwich, në Londër. Konkretisht është arrestuar shtetasi Oluwatimilehin Oniyitan, 20 vjeç i cili akuzohet për vrasjen e Boci, Ibrahim James, 21 vjeç i cili dyshohet të ketë qenë bashkëpunëtor, ndërsa ka rënë në pranga edhe Dominic Brown 29 vjeç. Jozef Boci, 30 vjeç, kishte marrë plagë të



Jozef Boci

Jozef Boci humbi jetën pasi u qëllua me sende të forta në kokë

Londër, goditën për vdekje shqiptarin, 3 në pranga

rënda në kokë pasi ishte qëlluar disa herë me sende të forta nga të paktën tre persona në Greenwich të Londrës të shtunën e kaluar. Policia dhe se Boci, i cili është nga Shqipëria por jetonte në Catfrod të Anglisë u sulmua pas një sherri ndërmjet dy grupesh të pub-i North Pole

në orët e para të mëngjesit. Ambulanca ishte lajmëruar rreth orës 12.15 të natës dhe zona mbeti e rrethuar nga policia edhe të nesërmen. Boci ishte dërguar në spital në gjendje të rëndë por nuk mundi të mbijetojë. Të akuzuarit ditën e sotme do të dalin përpara gjykatës në Bro-

mley për t'u njohur me akuzat për vrasjen e shqiptarit, Jozef Boci. Ndërkohë inspektori i policisë John Massey tha se sulmi ishte brutal dhe burracak. Ai i bëri thirrje të gjithë atyre që mund të kenë qenë të pranishëm në këtë incident, të paraqiten në polici dhe të dëshmojnë.

SHKURT



Shkatërrohet banda e drogës në Greqi, lider

35-vjeçari shqiptar

GREQI - Një 35-vjeçar shqiptar ka rënë në prangat e policisë greke, pasi akuzohet të jetë lideri i një bande kriminale, të cilët trafikonin drogë dhe kryenin vjedhje të herëpashershme. Në prangat e policisë fqinje kanë rënë edhe katër grekë të moshave, 42, 39, 34 dhe 23 vjeç si dhe tre shqiptarë të tjerë, të moshës 24, 29 dhe 35 vjeç. Bëhet me dije se banda ishte e ndarë në dy grupe. Grupi i parë kishte trafikuar kokainë me vlerë mbi 19.000 euro, duke ua shitur më shumë se 40 personave në Halkida, Eretria dhe Artaki. Ndërsa grupi i dytë, kishte trafikuar kokainë dhe kanabis të përpunuara me vlerë mbi 15.000 euro në rajonet e Evia. Gazeta greke "Protothema", shkruan se sipas hetimeve të policisë deri tani janë skanuar 15 vjedhje të kësaj bande dhe dy përpjekje me vlerë mbi 500.000 euro. Sakaq pas kontrolleve në banesat e të arrestuarve, janë sekuestruar makina të vjedhura, pajisje, bizhuteri, dhe të holla në shumën 104 595 euro, karta bankare, çeqe, shënime të ndryshme të shqyrtuara, dhe dy makina kamionë.

Aksion në kryeqytet, Policia Rrugore vendos mbi 1400 gjoba brenda 48 orëve

TIRANË - Policia Rrugore e Tiranës gjatë 48 orëve të fundit ka shtuar prezencën e saj, me qëllim parandalimin e aksidenteve rrugore. Gjatë fundjavës janë vendosur 1465 gjoba në rrugët e kryeqytetit dhe në autostradën Tiranë-Durrës. Bëhet me dije se 6 drejtues mjetesh kanë rënë në pranga, dy prej të cilëve drejtonin makinën në gjendje të dehur. Gjithashtu, janë tërhequr 68 Leje Drejtimi. Konkretisht 33 Leje Drejtimi janë tërhequr për shpejtësi tej normave të lejuara në qendra të banuara; 22 Leje Drejtimi për drejtim të automjetit nën ndikimin e alkoolit apo në gjendje të dehur dhe 13 Leje Drejtimi për shkelje të tjera. Uniforma blu bëjnë me dije se gjatë kontrollit me radarë, gjatë 48 orëve të fundit, është konstatuar se mjetet, në orët e vona të natës, qarkullojnë me shpejtësi dy herë më shumë se limiti i lejuar.

Ish-kryeministri Sali Berisha: Është fatkeqësi të kesh një pushtetar socialist komshi

Ina Allkanjari

SHKODËR

Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në fshatin Vukël të Shkodrës. Bëhet me dije se një konflikt mes fqinjësh ka degraduar në përdorimin e armëve. Pas një debati të nisur në orët e para të mëngjesit mes Mark Çelës dhe Vasel Vuçinajt, ky i fundit ka shkuar në shtëpi, ka marrë automatikun dhe ka qëlluar në drejtim të banesës së 51-vjeçarit. Mësohet se Mark Çela ka mbetur i plagosur në shtatull dhe ndodhet në spital, paraprakisht jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë policia e Shkodrës ka mundur të arrestojë në kohë rekord autorin Vasel Vuçinaj. Mësohet se autori i dyshuar i ngjarjes, Vuçinaj është kreu i Partisë Socialiste të Kelmendit. Sakaq sipas bluve në vendngjarje u sekuestruan 12 gëzhoja. Në lidhje me këtë ngjarje ka reaguar në rrjetin e tij social 'Facebook' edhe ish-kryeministri Sali Berisha. Ai thekson se është fatkeqësi të kesh një pushtetar socialist komshi.

Plagosi fqinjin në Shkodër, arrestohet kreu i PS në Kelmend, Vasel Vuçinaj

12 plumba drejt banesës së Mark Çelës, shkak dyshohet konflikti për tokën



I arrestuari, Vasel Vuçinaj



Arma e krimin

bitjeve që kryhen në Shqipëri, sipas një burimi të besueshëm janë me lidhje direkte apo të tërthorta me pushtetin socialist!

NGJARJA

Me datë 25.02.2018, në orët e para të mëngjesit, është

të marrë njoftim të salla operative se në fshatin Vukël, Malësi e Madhe, ka të shtëna me armë zjarri. Dyshohet se debati mes fqinjëve ka nisur për shkak të një konflikti për tokën. Vasel Vuçinajt se bashkë me viktimën kanë

qenë të ftuar në banesën e një prej shokëve për darkë, ku kanë pirë deri në orët e para të mëngjesit. Pas një debati të nisur në orët e para të mëngjesit, Vasel Vuçinaj, i cili është kryetar i Partisë Socialiste në Kelmend, ka shkuar në banesën e tij dhe ka marrë një armë zjarri të llojit automatik. Sipas policisë Vuçinaj pasi ka marrë automatikun ka qëlluar 12 herë në drejtim të banesës së Mark Çelës. Në momentin që 49 vjeçari ka qëlluar, në banesë kanë qenë të gjithë pjesëtarët e familjes Çela,

ndërsa i plagosur ka mbetur kryefamiljari Mark Çela. Ky i fundit mbeti i plagosur në shtatull dhe ndodhet në spital. Bëhet me dije se 51-vjeçari ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Menjëherë në vendngjarje mbërritën forcat policore të Sektorit Kundër Krimeve të Rënda, forcat policore të Komisaritit të Policisë Malësi e Madhe si dhe një grup i FNSH Shkodër për zbardhjen e plotë të ngjarjes si dhe kappjen e autorëve. Pas një pune të mirëorganizuar të forcave policore të ndodhura në vendngjarje, u bë i mundur lokalizimi dhe kapja në kohë rekord e autorit të dyshuar të kësaj ngjarje së bashku me armën e krimin. Konkretisht Vasel Vuçinaj, 49 vjeç, banues në fshatin Vukël, Malësi e Madhe. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit automatik si dhe në vendngjarje nga këqyrja u sekuestruan 12 gëzhoja. Ndërkohë vijojnë veprimet hetimore për dokumentimin e plotë të ngjarjes. Grupi hetimor po merr në pyetje autorin dhe të plagosurin për të zbardhur rrethanat e ngjarjes.



JOB PURPOSE:

Maximize Field Force productivity and effectiveness by driving key Global and Local Initiatives. Focus on building team capabilities and selling excellence in order to establish the Novartis Pharma Field Force as best-in-class based on internal and external benchmarks.

Some of his/her qualifications and requirements would be:

- University degree in Business & Administration, Medicine, Pharmacy, Biology, Chemistry or other relevant education.
- More than 5 years' experience in Pharmaceutical industry, in management of Field Force as well as in Sales Environment
- High Proficiency in English and local language (oral and written)
- Good leadership, management and planning skills.
- Excellent communications, interpersonal and negotiation skills.
- Ability to meet or exceed targets within agreed budgets and timescales – through effective leadership of the Medical Representatives team.
- Ensure effective management of the medical representatives team including training and personal development in terms of ongoing training, coaching and counseling through regular field visits and management of recruitment, performance, development and retention of representatives in the area through quality processes
- Implement with excellence the planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV-s and a Cover Letter (in English) at e-mail address: blerta.rambi@novartis.com. Deadline 07 March 2018. Only the selected candidates will be contacted.

SHPLLJE ANKANDI

Shoqëria përbarimorë gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., zhvillon Ankandin e Tretë për shitjen e pasurisë së paluajtshme Apartament, me sipërfaqe 98.39 m² (nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nënë metra katrorë), e regjistruar në Zonën Kadastrale Nr. 8603, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 322, datë 19.11.2004, Numri i Pasurisë 26/121+2-7, Vol. 17, Fage. 243, me adresë: Lajija "28 Nëntori", Vlorë, në pronësi të Edlira Aliaj, për kredinë e marrë pranë Bankës NBBG Albania Sh.a. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i tretë është 15,360.00 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 22.03.2018, ora 16:00, në adresën: Qendra e Zhvillimit të Ankandëve Publike Përbarimorë ("OZHAPP"), me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa Nr. 9, Kati 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përbarimorëve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Secili ofertues duhet të deponojë si garanci në llogarinë e ARB me IBAN AL21901110510027173510016018 në EURO pranë Bankës NBBG Albania shumë prej 10 % (dhjetë përqind) të çmimit fillestar. Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me shoqërinë përbarimorë gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall.: 21, Shk.: 3, Ap.: 3, Tiranë; tel: 042 252888; ose në adresën e email-it: info@arb.al

BANESAT SOCIALE SUGJERIMET

Aktivisti për të drejtat e qytetarëve thekson se shteti duhet t'i japë ndihmë njerëzve në nevojë

Avokati: Ja propozimet për disa ndryshime në projektligjin "Për strehimin social"

Adriatik Lapaj: Prishja e banesës të pezullohet deri në vendimin e gjykatës



Voltiza Duro

Për më shumë se një vit, po bëhet shqyrtimi i projektligjit "Për strehimin social" në parlamentin e Shqipërisë, që ka si synim përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi. Avokati dhe njëkohësisht aktivisti që mbulon të drejtat e qytetarëve në nevojë, Adriatik Lapaj tregon për "Gazeta Shqiptare" se ai vetë ka marrë pjesë në këtë proces prej fillimit dhe ka paraqitur idetë e tij në lidhje me disa ndryshime që duhen bërë në disa prej pikave të projektligjit. Avokati thekson se do të ishte më mirë që të merrej parasysh propozimi në bazë të të cilit paraqitja e kërkesës për sigurimin e padisë në gjykatë, të bëjë pezullimin e veprimeve të mëtejshme, pra të garantohet pezullimi i prishjes së banesës deri në vendimin e gjykatës. Në propozimet e tij për projektligjin, avokati shton se të gjithë individët që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të investimeve publike ose private, nuk do të përfitojnë kompensim vetëm në rastet kur njësi e vetëqeverisjes vendore dëshmon se nuk disponon asnjë alternativë tjetër strehimi në kuadër të programeve të tjera të strehimit social. "Kur personat janë pa të ardhura apo kanë të ardhura shumë të ulëta sipas përcaktimeve të këtij ligji, shteti garanton ofrimin e ndihmës ligjore falas sipas ligjit 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Gjithashtu, në nenin 18 projektligji jep përkufizimin e banesave sociale me qira por mënyra se si është përkufizuar nuk është shumë efektive pasi pronat në pronësi publike janë të patjetërsueshme", citohet në propozimet për ndryshimet e projektligjit "Për strehimin social". "Në këtë proces kam marrë pjesë prej fillimit ku dhe kam paraqitur këndvështrimin tim dhe propozime në vazhdim, një pjesë e të cilave dhe është pranuar. Në fazën aktuale që ndodhet projektligji ka ende disa pika që do duhet të përmirësohen përpara miratimit të tij final.", thekson avokati për "GSH". Sipas tij, projektligji fut mjaft koncepte të reja dhe në tërësi sjell mekanizma shumë të mirë

për të zgjidhur problematikat e strehimit. Ai do të jetë një mjet shumë i fortë në dorën e avokatëve të të drejtave të njeriut në vend, apo organizatave të shoqërisë civile që në fokus kanë strehimin. Ai do të jetë edhe një tërësi mundësish për njësitë vendore për të pasur më shumë hapësirë, mundësi dhe kapacitete për t'i dhënë zgjidhje problematikës së strehimit.

Ky projektligj fut për herë të parë në nenin 5 "Parimin e sigurisë së qëndrimit"

1. Qëndrimi në një vendbanim, strehim të përkohshëm ose të përhershëm është i pacenueshëm.

2. Në çdo rast, ndalohet dëbimi i individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre.



Adriatik Lapaj, avokati dhe aktivisti që mbulon të drejtat e qytetarëve në nevojë

3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, ndalohet zhvendosja e individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre.

Pikërisht ndalimi i dëbimit dhe zhvendosjes pa gjetur më parë një strehim alternativ është një mburojë shumë e rëndësishme për qytetarët, të cilët do duhet të zhvendosen nga vendbanimi tyre për shkak të investimeve publike.

Por projektligji ka dhe disa pika që duhet të përmirësohen të tilla si:

Neni 17 pika 2 dhe 3.

Procedurat e zhvendosjes:

2. Në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim bëhet i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, prishjet e objektit për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit ose raste të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera, njësi e vetëqeverisjes vendore:

a) nxjerr aktin administrativ për zhvendosjen nga banesa;

b) njofton individin/familjen 30 (tridhjetë) ditë para zhvendosjes;

c) nuk kryen prishjen e objekteve pa siguruar sistemimin me strehim të përshtatshëm të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpronësim.

3. Në çdo rast, individët/familjet që preken nga vendimi kanë të drejtë të kundërshtojnë zhvendosjen e tyre në Gjykatën Administrative. Nëse është e nevojshme, atyre u ofrohet ndihmë juridike nga institucionet shtetërore.

KOMENT

Pika 3, parashikon të drejtën e të prekurit nga zhvendosja për t'iu drejtuar gjykatës. Nga praktika e deritanishme kur gjykata shpreh objektin ishte prishur, pra gjykata gjykante pasi fakti ishte kryer duke u paragjykuar kështu dhe vendimi. Si shoqëri civile kemi propozuar që paraqitja e kërkesës për sigurimin e padisë në gjykatë të pezullojë veprimet e mëtejshme deri në vendimin e gjykatës për sigurimin e padisë, pra çdokush që gjendet përballë ekskavatorëve shtetërorë që duan t'i prishin shtëpinë të ketë mundësi që menjëherë t'i drejtohet gjykatës dhe paraqitja e kërkesës në gjykatë të jetë mjet që garanton pezullimin e prishjes deri sa gjykata të shprehjet.

Propozim

Neni 17 pika 3 të ndryshohet si më poshtë:

3. Në çdo rast, individët/familjet që preken nga vendimi kanë të drejtë të kundërshtojnë zhvendosjen e tyre në Gjykatën Administrative.

Procedura e zhvendosjes pezullohet në rastin e paraqitjes së kërkesës për sigurimin e padisë derisa gjykata të vendosë me vendim të ndërmjetëm për pranimin ose rrëzimin e kërkesës sipas afatit 5 ditorë nga paraqitja e kërkesës parashikuar në Kodin e Procedurës Civile.

Kur personat janë pa të ardhura apo kanë të ardhura shumë të ulëta sipas përcaktimeve të këtij ligji, shteti garanton ofrimin e ndihmës ligjore falas sipas ligjit 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

Gjithashtu, në nenin 18 projektligji jep përkufizimin e banesave sociale me qira por mënyra se si është përkufizuar nuk është shumë efektive pasi pronat në pronësi publike janë të patjetërsueshme.

Neni 18.

"Kuptimi i programit të banesave sociale me qira."

Koment

Në pikën 1 të këtij neni thuhet:

Të gjithë individët që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të investimeve publike ose private, nuk do të përfitojnë kompensim vetëm në rastet kur njësi e vetëqeverisjes vendore dëshmon se nuk disponon asnjë alternativë tjetër strehimi në kuadër të programeve të tjera të strehimit social.



Banesat sociale

"Programi i banesave sociale me qira është programi me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondit publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë dhe mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat."

Propozim

Mendojmë se duhet zëvendësuar termi "në pronësi publike" me termin "në pronësi shtetërore" dhe pika 1 duhet të marrë formën:

"Programi i banesave sociale me qira është programi me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi shtetërore nga fondit publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë dhe mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat."

Neni 19

"Fondi publik i banesave sociale."

Koment:

Pika 1 shkronja "c" parashikon: "blerje ose ndërtime të banesave nëpërmjet të ardhurave të siguruar nga taksa e ndikimit në infrastrukturën e grumbulluar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në masën jo më pak se 1 për qind të saj"

Pra fondit publik i banesave sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore përbëhet nga jo më pak se 1% e të ardhurave të siguruar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Kjo vlerë është shumë pak

Shembull me të dhëna zyrtare: Bashkia Tiranë: Për vitin 2016 të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ishin 928,454,660 Lekë, 1% e vlerës totale të ardhur nga taksa e ndikimit →



← në infrastrukturë është vetëm 9,284,546 (nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dyzetë e gjashtë lekë). Në terma optimist me këtë vlerë mund të bleh vetëm 3 shtëpi në qytetin e Tiranës në një kohë kur për vitin 2016-2017 janë regjistruar 5880 familje të pastreha.

Propozim
Propozojmë që shkronja "c", paragrafi 1 të ndryshojë si vijon: "blerje ose ndërtim të banesave nëpërmjet të ardhurave të siguruar nga taksa e ndikimit në infrastrukturën e grumbulluar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në masën jo më pak se 5 për qind të saj."

Neni 20
"Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik."

Koment
Pika 1 e nenit 20 duhet riformuluar. Është dukshëm një dispozitë që vendos në kushte të pabarabarta subjektet investuese në treg.

Propozim
Propozojmë që pika 1 të riformulohet si vijon:

"Çdo shoqëri ndërtuese ose investitor, që investon dhe kryen ndërtim me sipërfaqe ndërtimore banimi, për efekt përfitim, për çdo 2000 metra katrorë sipërfaqe ndërtimore, siguron kalimin pa shpërblym të të paktën 50 metrave katrorë sipërfaqe funksionale dhe që të plotësojë kushtet e një strehimit të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale me qira. Sipërfaqja respektive mund të konvertohet nga ndërtuesi në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi brenda të njëjtit njësi administrative."

Koment
Pika 2, që i referohet shtimit të volumit të ndërtimit është shumë evazive pasi nuk përcakton sa do të jetë sipërfaqja që kalon për llogari të strehimit social.

Propozim
Pika 2 e nenit 20 duhet të mirëpërcaktohet. Një variant mund të jetë:

"Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitim, kërkon rritje të volumit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në volum përkundrejt kalimit pa shpërblym në favor të fondit publik të banesave sociale me qira të 7.5% të sipërfaqes së krijuar si pasojë e shtesës në volumin e ndërtimit."

Neni 39 "Përcaktimi i vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë."

Koment
Pika 2 bie ndesh me parimin e përbalueshmërisë të parashikuar në nenin 3 pika 1, shkronja "b" dhe "c" të këtij projektligji.

Familjet do të stimuloheshin drejt sakrificës dhe ecjes përpara për t'u shkëputur nga varfëria, pasi ata e dinë që nuk po paguajnë më qira, por një këst për shtëpinë dhe çdo këst i afron edhe më shumë drejt pronësisë.

Propozim
"Pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë duhet të respektojë parimin e përbalueshmërisë së strehimit të parashikuar nga neni 3 i këtij ligji."

Neni 45 "Kuptimi i banesave sociale me kosto të ulët."

Koment
Nga mënyra se si është ndërtuar kapitulli VII "Programi i banesave me kosto të ulët", theksi vendoset të mundësia e blerjes së banesave me kosto të ulët nga ana e qytetarëve duke garantuar shteti interesat e kredisë, duke dalë garant për marrjen e kredisë apo duke dhënë dhe grante deri në 10% të vlerës së objektit, por në asnjë rast nuk parashikon mundësinë që qytetarët të mund të blejnë direkt të bashkia banesën që kjo e fundit ka në pronësi pa u dashur të futen në kredi në bankë. Nga mënyra se si është ndërtuar ky kapitull duket i mangët pasi me të drejtë parashikon sa thamë më sipër si mundësi (kreditimin, dorëzimin, grantin e menjëhershëm 10%) po përse të mos parashikojë dhe mundësinë që ato familje që e kanë një banesë me qira si rezultat i programit të banesave sociale me qira të parashikuar nga neni 10 germa (a) dhe që kanë qenë të rregullta në pagesa ose që plotësojnë kushtet për të përfutur sipas nenit 50 të këtij projektligji një banesë me kosto të ulët të mund ta blejnë atë banesë duke i paguar njësitë vendore vlerën respektive, e cila në çdo rast të mos jetë nën vlerën e koston së ndërtimit. Kjo mund të realizohet juridikisht përmes kontratës së shitblerjes me kusht pezullues, pra banesa qëndron me barrë hipotekore deri ditën që familja shlyen të gjithë vlerën e përcaktu-

Kur personat janë pa të ardhura apo kanë të ardhura shumë të ulëta sipas përcaktimeve të këtij ligji, shteti garanton ofrimin e ndihmës ligjore falas sipas ligjit 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

ar në kontratë. Shlyerja e vlerës së banesës me kosto të ulët nga familja do të bëhet përmes kështit të ndryshueshëm, i cili në parim përcakton një këst dysheme sa më të përbalueshëm dhe familja është e lirë që mbi këtë këst dysheme të mund të paguaj sa mundësi ka sipas muajve të ndryshëm, punësimi të anëtarëve të saj e me radhë. Çdo pagesë e familjes zbritet nga vlera e objektit i cili i kalon përfundimisht në pronësi ditën që ka shlyer të gjithë vlerën e kontratës. Kjo do sillte dy efekte pozitive:

Familjet do të stimuloheshin drejt sakrificës dhe ecjes përpara për t'u shkëputur nga varfëria, pasi ata e dinë që nuk po paguajnë më qira por një këst për shtëpinë dhe çdo këst i afron edhe më shumë drejt pronësisë. Kjo do ngjallte të familjet shpresë dhe do ishte një shtysë e mirë për të ecur përpara. Do ndihmohej fondi i banesave sociale të rinovohet me banesa të reja në vazhdim duke ulur kostot e mirëmbajtjes për bashkitë, të cilat me lekët e gjeneruara nga këstet e banesave të shitura me kontratë me kusht pezullues do mund të ushqenin skemën e strehimit social me objekte të reja.

Propozim:
Sa më sipër mendoj se duhet të shtohet dhe një pikë tjetër (konkretisht pika d) si më poshtë:
Neni 45 pika 4 parashikohet:
Për lehtësimin e blerjes së BKU-së nga përfutuesi përdoret njëri ose kombinimi i instrumenteve finan-

"Pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë duhet të respektojë parimin e përbalueshmërisë së strehimit të parashikuar nga neni 3 i këtij ligji."

ciare të mëposhtme:

a) Granti i menjëhershëm;
b) Subvencioni i interesave të kredive;

c) Garancia për marrjen e kredisë me dorëzani nga institucionet shtetërore ose garancia shtetërore për kreditë hipotekore, nëpërmjet institucionit investues, në rastin e përkeqësimit të të ardhurave të përfutuesit.

d) Kësti ndryshueshëm.

Neni 46

Koment

Nisur nga propozimi që në këtë kapitull të mund të parashikohet edhe mundësia e blerjes me këste drejtpërdrejtë të bashkia e banesave me kosto të ulët propozoj që neni 46 në pikën 1 të formulohet si më poshtë:

Format e sigurimit dhe burimet e financimit

Banesat me kosto të ulët sigurohen nëpërmjet:

Ndërtimit nga subjekte publike ose private;

blerjes nga tregu;

Kalimi nga programi i banesave sociale me qira të banesave që janë në pronësi të njësitë të vetëqeverisjes vendore ose banesave sociale me qira që janë financuar pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit, në programin e banesave me kosto të ulët në ato raste kur ka një kërkesë për blerje nga qiramarrësi.

Lihet siç është.....

Lihet siç është....

Kalimi nga programi i banesave sociale me qira në programin e banesave me kosto të ulët bëhet sipas kushteve dhe procedurave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Kushtet dhe procedurat e blerjes dhe shitjes së banesave me kosto të ulët si dhe kriteret për përcaktimin e çmimit të shitjes së truallit për familjet përfutuese miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57

"Streha e përkohshme dhe rastet e përdorimit"

Koment

Streha e përkohshme duhet të përmblushë parimin e banesës së përshtatshme neni 4, qasjes në shërbimet publike bazë dhe duhet të konsiderohet si alternativa e fundit e strehimit. Sa i takon pikën 2 shkronja c, "individë që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të investimeve publike ose private dhe nuk përfitojnë kompensim", mendojmë se këto raste nuk ndodhin në kushtet e urgjencës sikundër mund të jenë fatkeqësitë natyrore etj, pasi planet vendore si dhe procedurat e lejeve apo miratimit të investimeve janë të parashikueshme dhe shtrihen në kohë, e për rrjedhojë, vendosja e kategorive të parashikuara në shkronjën c në strehë të përkohshme duhet të jetë zgjidhja e fundit vetëm në ato raste kur mungojnë instrumentet për të zbatuar programet të tjera të strehimit social.

Propozim

Propozojmë që kategoria e parashikuar në pikën 2 shkronja c të hiqet.

Alternative: Pika 2, shkronja "c" të riformulohet si vijon: individëve që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të investimeve publike ose private dhe nuk përfitojnë kompensim, vetëm në ato raste kur njësitë e vetëqeverisjes vendore dëshmon se nuk disponon asnjë alternativë tjetër strehimi në kuadër të programeve të tjera të strehimit social.

Heqin shkronjat mbi objekt, ngel pa emër terminali i Shkupit

Largohet "Aleksandri i Madh" nga aeroporti i Maqedonisë

Ja cili është emri që do të zëvendësojë heroin maqedonas

Ditën e djeshme është hequr emri i "Aleksandrit të Madh" i cili dhjetë vite qëndronte mbi objektin e aeroportit të Shkupit. Shërbimet me shumë kujdes një nga një i larguan shkronjat e emrit nga terminali. Për momentin nuk dihet kur do të vendoset emri i tij "Aeroporti ndërkombëtar Shkup". Nga koncesionari turk TAV thonë se ata veprojnë sipas instruksioneve që i marrin nga qeveria. Jo zyrtarisht burime nga TAV - Maqedoni thonë se përveç emrit, nga hapësirat e aeroportit në të ardhmen do të hiqet edhe përmendoret e Aleksandrit të Madh, ndërsa do të ndryshohet edhe faqja e internetit të aeroportit. Për momentin nuk tregojnë se kur do të realizohen këto ndryshime. Ata nuk kanë informata edhe për atë se kur do të vendoset emri i ri në vend të emrit të vjetër. Për ndryshimin e emrit dje u pyetën se çfarë mendojnë disa nga pasagjerët që i takuan në aeroport. "Mendoj se mirë është që nga ana jonë shtrijmë dorën dhe themi se jemi të gatshëm të zgjidhet dhe tejkalohe problem. Tani, gjithsesi, politikanët janë ata që mes tyre duhet t'i zgjidhin dhe tejkalojnë problemet". "Ndoshta do duhet të quaj "Greqia" që t'u hakmerremi grekëve për Selanikun, sepse aeroporti i atjeshëm quhet Maqedonia. Por ne do nglemi maqedonas". "Jo vetëm ky, por duhet të ndërmerren edhe hapa të tjerë dhe njëherë e përgjithmonë të zgjidhet problemi. Ne më të mosuarit e kaluam jetën, por për të rinjtë duhet të ketë jetë". Gjatë ditëve të kaluara u larguan edhe tabelat për gjatë "Korridorit 10". Drejtori i ndërmarrjes publike për rrugë shërbetore, Zoran Kitanov thotë se tashmë po bëhen gati tabelat e reja ku emri i Aleksandrit të Madh do të zëvendësohet me "Miqësia". Gjithashtu, ndryshimi i emrave të aeroportit dhe autostradës është shenjë e vullnetit të mirë nga qeveria e Shkupit për përmirësimin e marrëdhënieve me Greqinë gjatë bisedimeve për zgjidhjen eventuale të çështjes së emrit. Mes mysafirëve të parë të lartë, të cilët do të zbrisin në aeroportin e ri emëruar do të jetë ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, njëfjalor Alsat. Intensifikimi i bisedimeve për çështjen e emrit është tregues se problemi ka hyrë në fazën serioze. Është moment kritik, prandaj kaq heshjtë, vlerëson profesori universitar Shpëtim Latifi. Kjo fshetësi se çfarë po diskutohet në opinionin i referohet ndjeshmërisë së negociatave në këtë moment.

"Ajo për të cilën ndoshta tani po "thyhen shtizat" është çështja e përdorimit të emrit "Erga Omnes". Qëndrimi i qeverisë greke është që emri i ri i Maqedonisë "Erga Omnes" do të nënkuptojë që ky emër të përdoret edhe brenda Maqedonisë, me çka nënkupton në mënyrë eksplacite ndërrimin e Kushtetutës, për të cilën qeveria e Maqedonisë është zotuar se nuk do të ndodhë", thotë profesori Shpëtim Latifi. Përfshirja në bisedime e temave që kanë të bëjnë me çështjen e identitetit, gjuhës dhe ndryshimi i Kushtetutës mund të ndërllojnë apo edhe të pamundësojnë gjetjen e një zgjidhjeje mes dy vendeve për emrin thonë njohës të çështjeve ndërkombëtare. "Në të kaluarën as që është biseduar për çështjen e identitetit dhe gjuhës,



pasi ato kryesisht ishin përgendruar në ndryshimin e emrit. Nuk di se pse tani hapen edhe këto çështje, të cilat në të kaluarën as që ishin në rend dite. Ende e kemi të paqartë se emri i ri do të përkthehet në anglisht, apo do të përdoret ai në gjuhën

maqedonase edhe për përdorim ndërkombëtar. Situata e njëjtë është e me gjuhën, se si mund të quhet gjuha ndryshe nga maqedonishtja, ajo që përdoret me vite e vite", thotë Vladimir Bozhinovski nga Instituti për Hulumtime Politike. Analisti Lupço

Risteviski thotë se negociatorët grek nuk kanë të drejtë që në tryezën e bisedimeve t'i hapin çështje siç janë identiteti, gjuha, kultura, sepse këto janë çështje më të shenjta për një komb. "Greqia nuk ka të drejtë të ketë pozicione dominuese dhe të kërkojë zgjidhje "Erga Omnes", pra të kërkojë ndryshimin e Kushtetutës. Kjo është e pakuptimtë dhe paraqet përzierje flagrante në punët e brendshme të Maqedonisë. Kuptohet se zgjidhje duhet të ketë, por ajo duhet të përshtijë vetëm çështjen e emrit, por jo aspekte të tjera si identitetin, gjuhën dhe të tjerat", thotë Risteviski. Por profesori Abdulla Azizi kërkon nga politika shqiptare të jetë e vëmendshme, pasi kur flitet për identitetin, në asnjë mënyrë nuk duhet harruar identitetin shqiptar. "Nuk është vetëm

PASAGJERËT E AEROPORTIT MAQEDONAS

"Mendoj se mirë është që nga ana jonë shtrijmë dorën dhe themi se jemi të gatshëm të zgjidhet dhe tejkalohe problem. Tani, gjithsesi, politikanët janë ata që mes tyre duhet t'i zgjidhin dhe tejkalojnë problemet". "Ndoshta do duhet të quaj "Greqia" që t'u hakmerremi grekëve për Selanikun, sepse aeroporti i atjeshëm quhet Maqedonia. Por ne do nglemi maqedonas". "Jo vetëm ky, por duhet të ndërmerren edhe hapa të tjerë dhe njëherë e përgjithmonë të zgjidhet problemi. Ne më të mosuarit e kaluam jetën, por për të rinjtë duhet të ketë jetë".

identiteti i maqedonasve këtu që preket, flasim për emrin e shtetit. Ku është identiteti i shqiptarëve, dikush e ka keqkuptuar këtë çështje dhe gjithçka që përmendet në Maqedoni e ka përvetësuar si emër ekskluziv me emrin e kombit që është shumicë në këtë shtet", - thekson profesori Abdulla Azizi.

Zbulohen detaje të reja lidhur me vrasjen e politikanit serb në Mitrovicë, Oliver Ivanović. Ky i fundit është qëlluar nga arma automatike "Heckler & Koch" e jo, siç ishte njoftuar më parë, nga një pistoletë Zastava M70A e kalibrit 9mm. Ky detaj është publikuar nga gazeta serbe "Veceerj Novosti", sipas së cilës atentatorët në ditën e vrasjes, më 16 janar më një veturë "Opel Astra", e kanë ndjekur Ivanoviçin, nga momenti kur ai doli nga banesa e tij në Mitrovicë, në rrugën "Lola Ribar", kanë kaluar pranë monu-

Atentati në Mitrovicë, ja si u ekzekutua në të vërtetë politikani serb

Vrasja e Oliver Ivanović, zbulohen detaje të reja



Oliver Ivanović

mentit të princit Lazar, duke e tejkaluar pastaj për ta pritur në veturë para selisë së partisë në rrugën "Sutjeska".

Kur Ivanović iu afrua portës së oborrit, në të cilën janë zyrat e partisë, vrasësi nga ulësja e pasme e veturës ka hapur zjarr mbi të, shkruan "Novosti". Sipas rezultateve të autopsisë, Ivanović u qëllua me gjashtë plumba në pjesën e sipërme të gjoksit. Vrasësit, sipas gazetës, me të njëjtën veturë kishin ikur në drejtim të shkollës së Mjekësisë, ku në rrugën "Vojvoda Putnik" kanë djegur veturën

"Astra". Edhe pse automjeti i djegur u gjet shpejt, brenda tij nuk u zbuluan gjurmët e atentatorëve. Duke përkujtuar se Shërbimi Policor i Kosovës për rajonin e Veriut para dy ditësh ka publikuar fotot e veturës "Astra", me të cilin kriminelët kanë ikur, gazeta shkruan se vetura "Astra" është ngjyrë hiri dhe pa targa, shkruan Telegraf. Ende nuk është verifikuar se si dhe kur automjeti ka hyrë në

territorin e Kosovës, kurse nga policia e Serbisë është shtënë informata se pronari i fundit i automjetit ishte një grua që e shiti atë në park të auto-mbeturinave, shkruan gazeta. Siç thuhet, automjeti, për të cilin u vërtetua se ka ndërruar disa pronarëve që nga viti 2009, mbërriti në Serbi, praktikisht është e vetmja gjurmë e prekshe me hetimin, për të cilin opinioni është informuar. Policia po vazhdon të marrë deklaratat nga njerëz që kanë qenë në kontakt me Ivanoviçin në ditët e fundit para vrasjes së tij dhe është duke pritur edhe raportin e thirrjeve telefonike.

Demarkacioni në Kosovë, deputetët do të votojnë edhe deklaratën

Haradinaj konfirmon marrëveshjen me LDK-në

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka konfirmuar dakordimin e tij me versionin e propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës për votimin e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Haradinaj është pajtuar që raporti i Komisionit Shtetëror për Kufirin, të jetë vetëm informues dhe jo pjesë e pakos së projektligjit për demarkacionin, i cili me gjasë, pritet të votohet të mërkurën. Krahas projektligjit për demarkacionin,

deputetët do të votojnë edhe për deklaratën e nënshkruar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Malit të Zi, Filip Vujanović, përmes së cilës të dy presidentët zotohen për korrigjimin e gabimeve eventuale gjatë demarkacionit të kufirit mes dyja shteteve. "Unë kam bërë një lëvizje politike, sipas kërkesës së LDK-së, duke u dhënë mundësi të deputetëve që të ecin përpara me marrëveshjen", ka thënë Haradinaj. Këto komente, Haradinaj i bëri gjatë një konferencë të jashtëzakonshme për media, pasi që para-

prakisht partitë politike në koalicionin qeverisës, Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën dhe partia opozitare Lidhja Demokratike Kosovës, kanë arritur një konsensus për votimin e demarkacionit. "Kemi një ndryshim substancial. Kemi dakordim me LDK-në dhe pas kësaj besoj se janë krijuar mundësitë për ratifikimin e marrëveshjes", tha Haradinaj. Në një përlllogaritje të thjeshtë, nëse PDK, AAK, Nisma dhe LDK bashkë me pakicat jo serbe në Kuvend



Ramush Haradinaj

e votojnë marrëveshjen, megjithatë nuk sigurohen ende 80 votat e kërkuara. Të gjitha këto subjekte së bashku kanë 78 vota gjithsej. Andaj, ratifikimi i demarkacionit mbetet ende i varur edhe nga 2 - 3 vota që duhet të sigurohen nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe. Megjithatë, deri në këtë fazë, Haradinaj ka konfirmuar po ashtu se nuk ka marrëveshje që garanton votat nga lista serbe, e cila

është pjesë e koalicionit qeverisës. "Ende nuk kemi konsensus me listën serbe, nuk e di a do të arrihet", tha Haradinaj. Komisioni Evropian e ka bërë të qartë se pa ratifikimin e demarkacionit, Kosova nuk do të mund të përfshihet në zonën e lëvizjes së lirë, brenda BE-së, pa viza. Marrëveshja për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi është nënshkruar në gusht të vitit 2015 në Vjenë. Si e tillë, kjo marrëveshje ishte ratifikuar nga Kuvendi i Malit të Zi, por jo edhe nga ai i Kosovës. Afati i fundit për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, në mënyrë që Kosova të përfshihet në axhendën për liberalizimin e vizave mbetet 28 shkurti, kur edhe është caktuar vazhdimi i seancës.



DR. ALTIN CEKODHIMA



Mënyrat për të trajtuar hepatitin B, shkaktarët dhe rrugët e transmetimit

KESHILLA



Përdorni limontoz për të parandaluar gurët në veshka

Albana Duni:

◆ Mjekja gastrohepatologe: Alkooli, duhanpirja dhe gurët në tëmth, shkaktarët kryesorë



Pankreatiti dhe mënyrat e trajtimit të tij

"Kujdes, mund të shkaktojë kancer të pankreasit"

• Efektet çudibërëse të çajit me limon e xhenxhefil

Mjekja gastrohepatologe: Alkooli, duhanpirja dhe gurët në tëmth, shkaktarët kryesorë

Albana Duni:

Pankreatiti dhe mënyrat e trajtimit të tij

"Kujdes, mund të shkaktojë kancer të pankreasit"

Voltiza Duro

Pirja e alkoolit në sasi të mëdha, duhani, apo dhe gurët në tëmth shpeshherë mund të japin dhimbje abdominale, e cila mund të përhapet edhe në pjesën e shpinës, madje edhe të vjella. Në këto raste personi mund të jetë prekur nga një inflamacion i pankreasit i njohur ndryshe si pankreatiti. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja gastrohepatologe, Albana Duni tregon se kjo sëmundje mund të prekë edhe fëmijët e më tej liston të gjitha simptomat kryesore që shfaqin pacientët e sëmurë. Mjekja bën me dije se trajtimi i pankreatitit mund të shkaktojë komplikacione serioze deri në kancer të pankreasit e liston të gjitha këshillat e mënyrat e kurimit të sëmundjes.

Cili është funksioni i pankreasit në organizmin e njeriut?

Pankreasi është një gjëndër që lokalizohet në pjesën e sipërme të barkut dhe e futur pas stomakut. Kjo gjëndër prodhon enzima që ndihmojnë digjestionin dhe hormone që rregullojnë nivelin e glicemisë në trupin tonë.

Cfarë është pankreatiti dhe cilat janë moshat më të prekura?

Pankreatiti është inflamacioni i pankreasit dhe prek moshën të ndryshme, por mund të prekë edhe fëmijët. Traumat e pankreasit

dhe pankreatiti i trashëguar janë dy faktorë të njohur që shkaktojnë pankreatit në fëmijëri. Fëmijët me fibrozë kistike të përparuar dhe me mosfunksionim të mushkërive mundet, gjithashtu, të preken nga pankreatiti. Në të shumtën e rasteve shkaku i pankreatitit tek fëmijët është i panjohur.

Si shfaqet ky inflamacion?

Pankreatiti shfaqet si pankreatit akut, që nënkupton shfaqjen e menjëhershme të tij dhe zgjat për disa ditë, por kemi dhe pankreatit kronik, që shfaqet për një kohë relativisht të gjatë që mund të përfshijë shumë vite.

Cilat janë shkaktarët kryesorë të sëmundjes?

Pankreatiti ka shumë shkaqe.

mentë si azathioprinë and 6-Mercaptopurine; ACE Inhibitorët (ku hyjnë antihypertensivët si enalapril); antidiabetikët (metformina) statins (atorvastatin, fluvastatin, simvastatin); antibiotikët (metronidazol dhe tetraciklina); acidi valproik (trajton migrenën, epilepsinë, dhimbjen neuropatike). Ndërkaq edhe duhanpirja është një ndër shkaqet kryesorë që ndikojnë në shfaqjen e pankreatitit. Në këtë të fundit mund të ndikojë edhe trashëgimia familjare e sëmundjes, nivelet e larta të kalciumit në gjak, nivelet e larta të triglicerideve në gjak; infeksionet; traumat e barkut; kanceri i pankreasit.

Cilat janë simptomat krye-



Janë identifikuar një numër shkaqesh të pankreatitit akut e kronik që përfshijnë alkoolizmin, gurët e tëmthit, kirurgjinë abdominale. Por kjo sëmundje shkaktohet edhe nga disa medika-

sore të sëmundjes?

Pankreatiti akut ka këto shenja dhe simptoma si dhimbje abdominale në zonën e stomakut por që mund të përhapet dhe në shpinë, e cila ndjehet më shumë



Mjekja gastrohepatologe Albana Duni

pas ushqimit. Por ky inflamacion mund të shkaktojë edhe të përziera apo të vjella, ndjeshmëri dhe mbrojtje kur prek barkun. Ndërkohe pankreatiti kronik përfshin këto shenja e simptoma si dhimbje e sipërme abdominale; humbje e rastësishme peshe; feçe të yndyrshme (steatorrhea). Pankreatiti shfaqet kur enzimat digjестive prodhuar nga pankreasi bëhen aktive duke shkaktuar dëmtim të organit. Ndërsa normalisht, gjatë digjestionit ose tretjes normale, enzimat pankreatike të paaktivizuara kalojnë nga kanalet pankreatike për në intestinin e hollë si duodeni (zorra e hollë) ku ato aktivizohen dhe ndihmojnë tretjen. Në pankreatit, enzimat bëhen aktive që në pankreas duke shkaktuar irritim të qelizave pankreatike, inflamacion dhe shenja e simptoma shogëruese të pankreatitit.

Si lind pankreatiti kronik?

Me përsëritjen e pankreatitit akut dëmtimet e pankreasit bëhen kronike duke u bërë kështu dëmtime të parikthyeshme e që manifestohen me humbjen e funksionit të pankreasit, me probleme digjестive dhe me diabet. Pra, pankreatiti akut kalon në kronik, por edhe një pankreatit kronik mund të akutizohet.

Cilat janë disa nga komplikacionet që mund të sjellë pankreatiti?

Rastet e lehta të pankreatitit (Mild pancreatitis) mund të kalojnë pa trajtim, por rastet vërtet të rënda mund të jenë kërcënuese për jetën duke shkaktuar komplikacione serioze. Shenjat dhe simptomat e pankreatitit ndryshojnë në varësi të tipit të tij. Një inflama-

cion që zgjat është një risk për transformime qelizore gjë që çon në zhvillimin e kancerit.

Si bëhet diagnostikimi i sëmundjes?


Testet dhe procedurat mjekësore që përdoren për diagnozën e pankreatitit përfshijnë analizat e gjakut për enzimat pankreatike; testet e feçeve për matjen e nivelit të yndyrës në feçe, gjë që sugjerojnë për mosabsorbim të nutrientëve ushqimore. Një tjetër mënyrë diagnostikimi është edhe skanerit (CT) pasi ka vlerë për identifikimin e gurëve dhe shtrirjen e inflamacionit në pankreas. Eko abdominale, gjithashtu, identifikon gurët në rrugët e tëmthit dhe inflamacionin. Ndërsa, endoscopic ultrasound ose EUS është ekzaminimi më i përzgjedhur për vlerësimin e pankreasit dhe të patologjive të tij.

Si realizohet trajtimi i pankreatitit?

Mënyra se si trajtohet pankreatiti varet nga forma e tij. Trajtimi i pankreatitit akut zakonisht kërkon hospitalizim për të stabilizuar gjendjen dhe inflamacionin dhe konkretisht përfshin ndërprerjen e marrjes së ushqimit nga goja në mënyrë që pankreasi të pushojë. Me kontrollin e inflamacionit kalohet gradualisht në dietë likide e më pas në dietë normale. Disa persona shërohen më shpejt ndërsa ata që kanë komplikacione kërkojnë kohë qëndrimi më të gjatë në spital. Rekomandohet pirja e një sasive të konsiderueshme uji 2-3 litra në ditë si dhe mbajtja e një peshe trupore normale e një aktiviteti i rregullt fizik. Vetëm me këto rregulla mund të parandalohen situata të tjera të pankreatitit.

Dr. Altin Cekodhima*

Hepatiti B është sëmundje e heparit (mëlçisë), e cila e bën atë të zmadhohet dhe të mos kryejë funksionet e saj siç duhet. Juve ju duhet një mëlçi e shëndetshme, sepse ajo kryhen një sërë funksionesh që ju mbajnë gjallë. Mëlçia sulmon infeksionet, ndalon hemorragjinë, eliminon drogat dhe helmimet nga qarkullimi i gjakut. Gjithashtu, ajo është depo energjish për ju të cilat hyjnë në funksion kur trupi juaj ka nevojë për to. Hepatiti B është sëmundje virale që do të thotë se shkaktohet nga një virus, i cili quhet virusi i Hepatitit B. Hepatiti B përhapet nëpërmjet kontaktit direkt me gjakun e një personi të infektuar, lëngut seminal (spermës), dhe lëngjeve të tjera të trupit.



Mënyrat për të trajtuar hepatitin B, shkaktarët dhe rrugët e transmetimit

Disa rrugë nga ku mund të merret hepatiti B janë:

- Marrëdhëniet seksuale me një person të infektuar pa përdorur kondom (prezervativ);
- Përdorimi i të njëjtës shiringë droge;
- Bërja e tatujeve dhe vendosja e pirsing duke përdorur mjete josterile ose të përdorura më parë nga shumë njerëz;
- Shpimi me aqe të kontaminuara (nga kjo mënyrë infektimi janë më të rrezikuar punonjësit e shëndetësisë);
- Bashkëjetesa me persona që kanë hepatitin B;
- Përdorimi i të njëjtës furçë dhëmbësh ose brisku rroje me persona të infektuar;
- Udhëtimi në vende ku hepatiti B është shumë i përhapur;
- Mosrespektimi i rregullave të sterilizimit të aparatave tek dentist;

Një grua e infektuar mund t'ia kalojë hepatitin B fëmijës gjatë lindjes ose gjatë ushqyerjes me gjë.

Ju nuk mund ta merrni hepatitin B nga:

- Shtrengimi i duarve me një person të infektuar;
- Përqaftimi me një person të infektuar;
- Ulja afër me një person të infektuar.

Simptomat

Hepatiti B mund t'ju bëjë të ndiheni sikur keni grip.

- Ju mund të:
- ndiheni të lodhur;
 - keni të përziera;
 - keni temperaturë të lartë;
 - keni humbje të oreksit;
 - keni diarre.

Disa njerëz kanë

- urinim me ngjyrë të errët si çaj;
- feçe me ngjyrë të zbardhur;
- zverdhje të syve dhe lëkurës.

Disa njerëz nuk kanë fare shenja

Në qoftë se ju keni ndonjë nga shenjat e lartpërmendura ose



Dr. Altin Cekodhima, mjek gastrohepatolog

mendoni se mund të jeni infektuar nga hepatiti B, duhet të takoni doktorin specialist.

Diagnostikimi

Për të parë nëse jeni të infektuar apo jo, doktori do t'ju rekomandojë disa analiza laboratorike të gjakut. Këto analiza do të konfirmojnë nëse keni hepatitin B dhe se në çfarë stadi është gjendja. Doktorit mund t'i lindë nevoja të marrë biopsi në hepar me anë të një procedure të thjeshtë. Doktorit merr disa copëza shumë të vogla nga mëlçia juaj nëpërmjet një ajeje të drejtuar nën ekografi, të cilat pasi përpunohen në laborator shihen në mikroskop dhe vlerësojnë dëmtimet e mëlçisë.

Për të parë nëse jeni të infektuar apo jo, doktori do t'ju rekomandojë disa analiza laboratorike të gjakut. Këto analiza do të konfirmojnë nëse keni hepatitin B dhe se në çfarë stadi është gjendja. Doktorit mund t'i lindë nevoja të marrë biopsi në hepar me anë të një procedure të thjeshtë

Trajtimi

Trajtimi për hepatitin B mund të përfshijë:

- Interferonin, i cili mund të merret për më shumë se 4 muaj;
- Lamivudin, i cili mund të jepet për një vit.
- Adefovir dipivoxil, i cili mund

të merret për një vit.

- Kirurgjia. Në disa raste hepatiti B mund të nxjerrë jashtë pune mëlçinë tuaj, që do të thotë se ajo është kaq e dëmtuar saqë nuk kryen asnjë funksion, prandaj ju do të keni nevojë për një mëlçi të re. Kjo

lloj kirurgjie quhet transplant, i cili konsiston në heqjen e organit të vjetër dhe vendosjen e një të riu të padëmtuar të dhuruar nga një dhurues i shëndetshëm. Vaksinimi është një mënyrë mbrojtjeje. Vakina është një ilaç të cilin ju e merrni kur jeni i shëndetshëm dhe ju mbron që të mos infektoheni. Ajo përgatit organizmin tuaj të sulmojë të tilla viruse, në rastin konkret hepatitin B. Vakina e hepatiti B jepet duke u bërë në tri doza. Çdo i porsalindur duhet të marrë vaksinën e hepatitit B. Doza e parë u jepet foshnjave 12 orë pas lindjes. Dozën e dytë të vaksinës e marrin pas 1ose 2 muajsh dhe dozën e tretë e marrin pas muajit të gjashtë apo të tetë të jetës. Mund të vaksinohen edhe fëmijët më të rritur dhe të rriturit. Ata mund t'i marrin të tre dozat me një diferencë kohore 6 muaj nga njëra dozë në tjetrën. Ju duhet t'i merrni patjetër të tre dozat që të imunizoheni (të jeni të mbrojtur), ndaj hepatitit B.

Ju, gjithashtu, mund të mbrojni veten ndaj infektimit duke:

- përdorur prezervativ gjatë marrëdhënieve seksuale sidomos kur keni më shumë se 1 partner;
- mos përdorur shiringa të përdorura më parë;
- veshur doreza kur manipuloni ose kur ju duhet të preknit gjakun ose plagët e dikujt tjetër;
- mos përdorur furçën e dhëmbëve dhe briskun e rrojës të një personi të infektuar;
- u siguruar që mjetet e bërjes së tatujeve dhe vendosjes së pirsingut të jenë sterile, të përdorura më parë.

Këshilla



Përdorni limonoz për të parandaluar gurët në veshka


Limonoz apo acidi citrik është një substancë që gjenet tek shumë fruta si limonët, portokallët, qitro, kivi, mollët, luleshtrydhet, dardhat, qershitë, mandarinat. Këto substancë e gjejmë edhe tek patatet, bizelet, kërpudhat, shpargu dhe domatet. Acidi citrik përdoret edhe për të ruajtur jetëgjatësinë e një produkti farmaceutik apo

pijeve si dhe për t'u dhënë aromë ushqimeve apo për të pastruar shtëpinë. Limonoz ka natyrë alkaline dhe ekuilibron nivelet e acidit në organizëm e shërben si antioksidant ndaj është miqësor me lëkurën.

Në aplikimet në lëkurë, kjo substancë largon qelizat e vdekurra dhe e mban atë të butë. Acidi citrik përmirëson shëndetin e veshkave duke parandaluar formimin e gurëve, ndërsa si antioksidant ai largon radikalet e lira, përgjegjëse për zhvillimin e qelizave kancerogjene.

maska shtëpie për pastrimin dhe ushqimin e lëkurës, pasi është ideal kundër njollave të akneve, rrudhave dhe shenjave të moshës. Një nga maskat më të mira përfshin pëzierjen e çerek gote me ujë, çerek gote me qumësht pa yndyrë, dhe dy lugëve me limonoz pluhur. Pastën e formuar vendosin në lëkurë dhe mbajeni për 15 minu-

ta. Por konsumi i tepërt i acidit citrik mund të jetë i dëmshëm pasi mund të shkaktojë dhimbje abdominale, të vjella, mungesë oreksi, marramendje, diarje dhe rënie të tensionit të gjakut. Njerëzit që vuajnë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe gratë shtatzënë duhet ta shmangin këtë produkt sepse përthith mineralin e nevojshme



Efektet çudibërëse të çajit me limon e xhenxhefil

Një ndër lëngjet më të mira që mund të pini gjatë kësaj stine të mbushur me viroza dhe bakteret, është çaji me xhenxhefil dhe limon.

Kjo pije, jo vetëm që largon stresin, por edhe përkujdeset për organizmin në mënyrën më fantastike pasi limoni është një burim i jashtëzakonshëm i vitaminës C që luan rolin e një antibiotiku natyral dhe shumë efikas, ndërsa bioflavonoidët tek limoni parandalojnë zhvillimin dhe shpërndarjen e qelizave tumorale. Antioksidantët tek zbusin inflamacionin dhe largojnë radikalet e lira, ndërsa xhenxhefili rrit qarkullimin e gjakut që është thelbësore për një shëndet të mirë. Pirja e rregullt e këtij çaji shmang dëmin e veshkave si pasojë e diabetit e niveli i lartë i zinkut tek xhenxhefili luan një rol kryesor në sekretimin e insulinës. Kjo e fundit kontrollon nivelin e sheqerit në gjak dhe mban diabetin nën kontroll. Ndërkohë ky çaj



është i pasur me antioksidantë dhe vitamina që janë thelbësore për flokë, lëkurë dhe shëndet perfekt. Kjo pije përmirëson tretjen dhe e mbron lëkurën nga infeksionet si dhe përmirëson paraqitjen rinore të lëkurës. Nga ana tjetër, xhenxhefili ndihmon për normalizimin e sheqernave në gjak e ndikon pozitivisht në aftësinë tuaj për të rënë në peshë ose për t'u ushqyer shëndetshëm. Kjo bimë përmirëson aftësitë përthithëse të yndyrës nga trupi dhe largon inflamacionin në mëllç. Çaji me xhenxhefil dhe limon largon të pëzierat dhe të vjellat, madje rekomandohet edhe kundër problemeve me stomakun, urthin dhe tretjen. Pija pikante përmirëson tretjen e ushqimeve dhe parandalon fryrjen.

ISH-PRONARËT KOMPENSIMI

Ish-pronarët që janë kundër vlerësimit financiar që ka vendosur 'Agjencia' mund të ankimojnë

ATP: 1500 dosjet e vitit '97, vlerësimi për çdo pronar

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtit të Pronat ka vlerësimet financiare për ish-pronarët që kanë dorëzuar kërkesën për kompensim në vitin 1997. Agjencia bën të ditur se në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikën në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Lista e përditësuar është botuar edhe në Fletoren Zyrtare.

Përfituesit në të gjithë vendin, dokumentet për të marrë paratë

APLIKIMI PËR KOMPENSIM

Pronarët që janë dakord me vlerësimin e ATP-së kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Përfituesit duhet të dorëzojnë në ATP nëntë dokumente për të marrë 20% të vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik. Shifrat janë bërë të ditura nga burime zyrtare pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave, sipas të cilave mësohet se të gjithë pronarët për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në 'Agjenci' për të dorëzuar kërkesën për kom-

mpensim, konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim); dëshmi trashëgimie, prokurë, deklaratë noteriale e nënshkruar nga subjekti i shpronësuar, vërtetim për numrin e logarisë bankare, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Ndërkohë, pronarët që nuk janë dakord me vlerësimin duhet që brenda 30 ditëve nga data e publikimit të listës të ankimojnë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit.

DOKUMENTET

1. Kërkesë për kompensim.
2. Konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim).
3. Dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve.
4. Prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë dhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre.
5. Deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar/përfaqësuesi me prokurë i të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar, përmes së cilës subjektet vetëdeklarojnë nëse vendimi përfundimtar i kompensimit apo vlerësimi i tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, si dhe nëse këto subjekte kanë qenë apo jo të paditur apo persona të tretë në proceset, për të cilët ata aplikojnë për kompensim, janë kundërshtuar apo jo gjyqësisht nga ana e tyre, si dhe nëse këto subjekte kanë qenë të paditur apo persona të tretë në proceset gjyqësore me objekt ankimim e vendimit për të cilin ata aplikojnë.
6. Deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar/përfaqësuesi me prokurë të të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar, përmes së cilës subjektet vetëdeklarojnë nëse kanë përfitur apo jo nga dispozitat e ligjit për ndarjen e tokës bujqësore.
7. Vërtetim për numrin e logarisë bankare.
8. Dokument identifikimi.
9. Mandatpagese.

Data/Dosje	Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqja e Njohur/Mosnjohur	Sipërfaqja e kompenzuar	Sip. për kompensim përfundimtar e	VLERESIMI
						Sipërfaqja m2 totale	
30-08-1994	Korçë	LUAN KOLAMI		4592	1085	1085.00	-232,552
25-01-1996	Korçë	Teqi Gegoli		2835	2835	2835.00	
24-08-1994	Korçë	Eqerem Avdhi		609	609	609.00	103,530
05-11-1996	Dibër	BARDHYL KADIU		100160	100160	100160.00	3,088,739
11-12-1995	Lezhë	Frok Llesh Reçi		50970	0	0 dhe Parablerje: 130	-2,768,525
01-01-1901	Lezhë	Gjon Mark Reçi		8169	4281	4281.00	2,845,484
21-11-1995	Tiranë	Besnik Bashmeta, Halli Bashmeta			0	0	
04-01-1997	Tiranë	RAMIZ CELA		1000	1000	1000.00	329,000
31-08-1994	Tiranë	XHEMILE MALIQATI		30000	12000	12000.00	3,948,000
30-12-1996	Tiranë	HAMIDE KOKA		2300	2300	2300.00	
06-09-1995	Tiranë	Kadije Dedej (Dervishi)		24100	24100	24100.00	723,552
24-06-1995	Tiranë	MEREME XHAHYSA (KAJA)			8000	8000.00	414,829
29-03-1996	Tiranë	Drita Gashi, Feride Gashi, Sker		28000	28000	28000.00	1,570,913
15-03-1996	Tiranë	ANISHA HENCI			56658	56658.00	3,190,836
18-03-1996	Tiranë	Mereme Hoti (Boktini), Xhema		21400	21400	21400.00	1,197,704
03-06-1995	Tiranë	Sadete Hadja, Shyqyri Hadja		5500	5500	5500.00	2,585,000
28-06-1996	Tiranë	FATIME, OLIMBI, KUMBULI		186700	186700	186700.00	7,502,418
06-01-1997	Tiranë	HATIXHE CELPICA		9200	9200	9200.00	3,026,800
02-04-1996	Tiranë	Ali Thertori			0	0	659,569
18-09-1996	Tiranë	Haxhi Hallulli, Shelqet Hallulli			0	0	1,826,812
23-10-1996	Tiranë	Arta Fagu		60000	60000	60000.00	3,424,805
26-09-1996	Tiranë	Ramiz Çela		10452	10452	10452.00	458,066
28-06-1996	Tiranë	Ramiz Cara		95000	95000	95000.00	5,317,211
01-01-1901	Dibër	Qemal Allamani		52630	52630	52630.00	2,055,808
01-01-1996	Korçë	Hasan Emin Skerra		65308	65308	65308.00	2,551,030
01-01-1994	Vlorë	Astrif Kallapodhi			0	0	
01-01-1996	Korçë	Zkuli Karanxha		1433.3	1433.3	1433.30	55,987
01-01-1901	Dibër	Ramazan Çeku		5300	5300	5300.00	
01-01-1996	Korçë	Yzret Meço		940	699	699.00	232,068

Data/Dosje	Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqja e Njohur/Mosnjohur	Sipërfaqja e kompenzuar	Sip. për kompensim përfundimtar e	VLERESIMI
						Sipërfaqja m2 totale	
29-03-1996	Korçë	Viktor Konomi		1520	417	417.00	-12,669
23-12-1996	Vlorë	Myzejen Zejnati		6100	6100	6100.00	
01-01-1901	Fier	Shelqet Buzi		120120	120120	120120.00	7,682,923
01-01-1901	Fier	Thoma Haxhistasa		37000	37000	37000.00	
11-01-1995	Fier	Thomas Duda		510800	510800	510800.00	9,173,566
29-12-1994	Fier	Bilbil Kerri		150000	150000	150000.00	
01-01-1901	Fier	Hysen Çoçoli		42000	42000	42000.00	
01-01-1901	Fier	Përparim Alizoti		56000	56000	56000.00	3,121,268
01-01-1994	Gjrokastër	Spartak Xhuvani		5745	515	515.00	-413,340
01-01-1994	Gjrokastër	Shezai Shehu		5957	3590	3590.00	323,182
01-01-1994	Gjrokastër	Kristaq Çipi		1632	1185	1185.00	
01-01-1994	Gjrokastër	Foni Dito		400	300	300.00	73,800
06-01-1994	Korçë	Gurtali Fezulli		3075	190	190.00 dhe Parablerje: 288	
29-08-1994	Korçë	Kostandina Ktona		814	0	0 dhe Parablerje: 254	
22-08-1996	Korçë	Xhvedet Dervishi		343	343	343.00	675,710
18-08-1994	Korçë	Kujtim Demko		750	750	750.00	99,500
29-08-1994	Korçë	Shpëtim Çausllari		1325	1325	1325.00	254,400
24-03-1994	Korçë	Ropi Shurdhi		1540	669	669.00	-18,458
01-09-1995	Korçë	Ibrahim Qose		2400	2400	2400.00	240,000
30-08-1994	Korçë	Novruz Pino		2000	2000	2000.00	190,000
31-08-1994	Korçë	Bajram Pane		617	617	617.00	
11-05-1994	Korçë	Vangjel Peleku		3500	3500	3500.00	773,500
19-07-1994	Korçë	Shpëtim Iliri		4000	4000	4000.00	400,000
04-03-1996	Elbasan	MUHAMET GJONI		11800	11800	11800.00	165,749
08-02-1994	Elbasan	XHEMAL STOJKU		2235	2235	2235.00	1,633,731
01-01-1996	Korçë	Kadrije Agolli		4571	4571	4571.00	219,272
01-01-2003	Korçë			10100	10100	10100.00	1,010,000
25-06-1996	Elbasan	DEMIR REXHEPI		18350	18350	18350.00	
01-01-1993	Vlorë	Koco Kristo		10127	9127	9127.00	

01-01-1997	Vlorë	skender Godo	7000	7000	7000.00	
01-01-1996	Korçë	Vasfi Staro	2140	2140	2140.00	
01-01-1996	Korçë	Gurali Dervishllari	3325	3325	3325.00	
01-01-1996	Korçë	Vasfi Nevrus	127275	127275	127275.00	3,924,912
01-01-1994	Vlorë	Vasil Dharmi	624	624	624.00	54,912
01-01-1996	Korçë	Ylli Sulo	59200	55200.2	55200.20	1,398,086
01-01-1996	Korçë	Xhelal Vasha	44920	33000	33000.00 dhe Parabletë:119	1,289,030
01-01-1994	Durrës	Sanje Hoti	25000	12500	12500.00	-2,275,000
01-01-1994	Durrës	Bahitje Feri	25000	25000	25000.00	2,925,000
01-01-1997	Durrës	Hysen Dizdari	8000	8000	8000.00	936,000
01-01-1996	Durrës	Jovan Prifti	15515	5515	5515.00	
01-01-1901	Durrës	Ramazan Dika	2000	2000	2000.00	862,000
01-01-1901	Durrës	Fadil Feri	25000	25000	25000.00	
01-01-1901	Gjirokastrë	Poi Xhelo	650	390	390.00	55,770
01-01-1994	Korçë	Gjergji Shkurti	355	147	147.00	
01-01-1996	Korçë	Eleri Fushii	300	300	300.00	643,500
01-01-1994	Korçë	AHMET ÇETA	1240	316	316.00	
01-01-1901	Korçë	Nuri Pleku	5740	1500	1500.00	261,180
01-01-1996	Tiranë	HYKA		0	0	1,719,366
01-01-1901	Gjirokastrë	Novruz Varfi	20250	20250	20250.00	
18-03-1996	Korçë	Selami Elezi	34500	34500	34500.00	1,010,207
19-03-1996	Korçë	Soit' Robo	38900	38900	38900.00	523,119
13-03-1996	Korçë	Avdulla Myteveli	43000	43000	43000.00	1,958,607
20-03-1996	Korçë	Neki Kroj	100850	100850	100850.00	1,356,211
01-01-1901	Korçë	Guri Tili	12000	12000	12000.00	278,500
23-02-1996	Korçë	Qani Lazellu	11000	11000	11000.00	147,926
03-04-1996	Korçë	Sefer Kacka	17800	17800	17800.00	413,108
12-03-1996	Korçë	Bedri Spahllari	55000	55000	55000.00	2,124,536
27-01-1995	Korçë	Ramadan Hysollari	120440	120440	120440.00	
01-01-1901	Korçë	Teki Kodrasi	27000	36999	36999.00	497,558
28-07-1994	Berat	NURI ÇONGO	7280	7280	7280.00	877,968
28-07-1994	Berat	NURI ÇONGO	12990	12990	12990.00	380,367
19-12-1996	Berat	Qemal Akshani	1200	1200	1200.00	35,138
19-12-1996	Berat	Qemal Akshani	20000	20000	20000.00	585,630
15-07-1994	Berat	Fatime Llango	63900	61350	61350.00	1,423,829
27-09-1996	Berat	Bido Duçellari	125200	125200	125200.00	1,683,665
12-03-1996	Berat	Xhvedet Molla	119000	119000	119000.00	3,478,642
05-04-1996	Korçë	Demirali Collaku	47000	47000	47000.00	2,140,803
30-12-2014	Gjirokastrë	Qani Veiz Jeniceraj	4570	4570	4570.00	3,150,256
25-04-1996	Korçë	Kristo Plaku	119599	118700	118700.00	11,304,583
20-09-1996	Durrës	Ibrahim Halili	28676	28676	28676.00	1,063,654
29-08-1994	Durrës	Shaban Kurti	932	932	932.00	3,738,252
23-08-1994	Durrës	Mehmet Hoxha	1104	357	357.00	
09-05-1996	Elbasan	XHAZAI SULOLLARI	19914.6	19914.6	19914.60	583,129
28-03-1996	Elbasan	RAKIPE ZENEL GURRA (KA	4425	4425	4425.00	129,571
01-01-1901	Gjirokastrë	Vangjel Angjeli	2644	144	144.00	72,421
14-05-1996	Dibër	SHAQIR KOKA	15536	4700	4700.00	
29-06-1994	Korçë	Radium Avxhi	1800	1800	1800.00	306,000
02-02-1996	Dibër	LIHE PALI	12250	3850	3850.00	
31-08-1994	Korçë	Huan Agolli	10110	10110	10110.00	1,011,000
29-03-1994	Dibër	MYFTAR SINANI	9424	5500	5500.00	3,660,480
31-08-1994	Korçë	Llazar Morcka	1970	1740	1740.00	
30-08-1994	Korçë	Viktor Xhelati	4400	4400	4400.00	440,000
05-01-1996	Korçë	Fehim Aska	1000	1000	1000.00	223,000
31-08-1994	Korçë	Qerim Tahiri	715	715	715.00	71,500
05-04-1996	Dibër	DYLEJMAN TUSHA	9765	9765	9765.00	
31-08-1994	Korçë	Adem Imami	900	900	900.00	150,000
31-08-1994	Korçë	Xhelil Xhaholli	1519	1519	1519.00	
06-02-1996	Korçë	Valentina Duçi	720	720	720.00	142,560
04-12-1995	Korçë	Vasil Jani	3000	3000	3000.00	636,000
18-08-1994	Korçë	Ollga Xhelo	2240	2240	2240.00	
12-12-1996	Korçë	Gago Koroveshti	625	395	395.00 dhe Parabletë:100	91,065
31-08-1994	Korçë	Safet Bashiani	509	509	509.00	
31-08-1994	Korçë	Aferdita Spaho	2600	2600	2600.00	
30-08-1994	Korçë	Hekuran Bashllari	700	0	0 dhe Parabletë:700	0
01-01-1901	Lezhë	Gjet Mamli	398	0	0 dhe Parabletë:398	0
01-01-1901	Korçë	Soit' Ruço	1056	1056	1056.00	1,874,400
01-01-1901	Gjirokastrë	Aferdita Xhitoni		21163	21163.00	

01-01-1901	Dibër	Fiqiri Çuka		4800	3900	3900.00	
01-01-1997	Gjirokastrë	Qeriba Gjylaj		37000	37000	37000.00	
01-01-1996	Korçë	Ismail Hanelli		13000	13000	13000.00	174,821
08-05-1996	Korçë	Ylvije Takelli		6750	6750	6750.00	250,357
14-05-1996	Korçë	Hysen Shatko		12000	12000	12000.00	
27-09-1996	Korçë	Vasili Morcka		12730	12153	12153.00 dhe Parabletë:577	450,753
09-01-1996	Korçë	Shyqyri Hoxhalli		19558	19558	19558.00	453,907
13-03-1996	Korçë	Nefi Bacelli		19000	15834	15834.00	212,929
22-02-1996	Korçë	Shyqyrie Abedini		2000	2000	2000.00	98,802
20-03-1996	Korçë	Selvika Zui		12500	12500	12500.00	168,095
19-02-1996	Korçë	Andon Naumi		6000	6000	6000.00	273,294
13-03-1996	Korçë	Bari Sulollari		54225	54225	54225.00	
12-03-1996	Korçë	Medat Mero		127943	127944	127944.00	5,827,721
18-03-1996	Korçë	Gjergji Nikolli		31429	31429	31429.00	1,431,560
13-03-1996	Korçë	Hysen Lipo		53253	29334	29334.00	394,474
19-02-1996	Korçë	Servet Lari		36470	30220	30220.00	1,376,491
09-10-1996	Korçë	Hekuran Zenelaku		22334	22334	22334.00	653,973
01-01-1996	Korçë			16000	16000	16000.00	468,504
01-01-1996	Korçë	Zani Barolli		7332	7332	7332.00	214,041
22-02-1996	Korçë	Mazlëm Zyçe		12000	12000	12000.00	222,539
21-06-1996	Dibër	ZABIT AHMET BICI		996	996	996.00	23,115
27-06-1996	Dibër	TAHIR RAMADAN ZENELI		15225	15225	15225.00	
30-09-1997	Dibër	AGIM GJOKA		2877	2877	2877.00	335,097
01-01-1996	Korçë	Nazif Shaholli		8026	8026	8026.00	17,408
01-01-1996	Korçë	Garazi Demiraj		11333	11333	11333.00	420,339
09-05-1996	Korçë	Adem Abidin		58400	58400	58400.00	1,710,040
01-01-1996	Korçë	Leonard Pasterma		26580	26580	26580.00	778,302
01-01-1901	Lezhë	Barth Ndoji		4816	4816	4816.00	292,485
01-01-1996	Vlorë	Bastri Hasani		404	1972	1972.00	0
01-01-1995	Lezhë	Kol Zef Gjinaj		3180	3180	3180.00	193,128
01-01-1997	Gjirokastrë	Petrit Malq Sinomataj		25900	25900	25900.00	
01-01-1996	Korçë	Ibrahim Subashi		18843	18843	18843.00	858,280
01-01-1996	Korçë	Hekuran Gjiriti		36000	36000	36000.00	1,054,134
01-01-1996	Korçë	Spiro Sorba		28000	14000	14000.00	324,916
01-01-1996	Korçë	LLAZI KOVACI		1650	0	0 dhe Parabletë:700	-255,200
29-03-1996	Korçë	Skender Shkëmbi		8000	6304	6304.00	460,800
31-08-1994	Korçë	Gjergji Burda		3000	1500	1500.00	
06-04-1994	Korçë	Ligor Mançe		200	200	200.00	20,000
31-08-1994	Korçë	Janulla Gjata		332	332	332.00	33,200
03-01-1997	Korçë	Hajrije Lisi		1000	1000	1000.00	100,000
31-08-1994	Korçë	Ajdn Mecollari		4000	4000	4000.00	400,000
30-08-1994	Korçë	Jonel Nasto		7550	5915	5915.00	432,870
30-08-1994	Korçë	Todi Çollaku		239	239	239.00	47,322
31-08-1994	Korçë	Dalip Shkëmbi		665	665	665.00	66,500
31-08-1994	Korçë	Fevri Bylykbashi		554	554	554.00	55,400
29-03-1994	Korçë	Shenjtor Hoxhalli		850	464	464.00	91,408
13-02-1997	Korçë	Yber Mullali		546	160	160.00 dhe Parabletë:152	31,520
24-08-1994	Korçë	Engjell Bushi		139.6	139.6	139.60	0
17-05-1996	Korçë	Hekuran Mullali		4180		4180.00 dhe Parabletë:76	418,000
18-08-1994	Korçë	Xhevat Agolli		11832	8632	8632.00	1,567,744
03-12-1996	Tiranë	HAKI XHAJA		3200	325	325.00	-75,775
21-10-1997	Tiranë	KOMUNITETI MYSLYMAN		12550	9770	9770.00	-1,494,400
01-01-1994	Korçë	Xhemal Qyteza		7881	5425	5425.00	374,724
01-01-1996	Korçë	Kista Ortodokse		1780	1700	1700.00	584,800
01-01-1996	Korçë	PETRI TOMORRI		10000	10000	10000.00	123,633
01-01-1996	Korçë	Petraç Pine		31000	31000	31000.00	907,727
01-01-1996	Korçë	LEFKOTHE PETE		6500	6500	6500.00	190,330
01-01-1996	Korçë	Medeat Bylyku		19480	19480	19480.00	
01-01-1996	Korçë	Nafiz Tale		15375	15375	15375.00	570,256
01-01-1996	Korçë			36000	36000	36000.00	1,335,236
01-01-1901	Shkodër	Hydajet Kuçi		80806	16541	16541.00	
01-01-1997	Gjirokastrë	Fejzo Zaçaj		7560	4140	4140.00 dhe Parabletë:347	
01-01-1997	Gjirokastrë	Xhafer Beqo Osmani		25180	25180	25180.00	338,616
31-10-1996	Korçë	Fadilë Spaho		22069	22069	22069.00	818,537
25-06-1996	Korçë	Leni Rado		10988	10988	10988.00	321,745
01-01-1996	Korçë	Soit' Toçe		5000	5000	5000.00	146,408
19-03-1996	Korçë	Vangjel Morcka		9000	9000	9000.00	333,809

(vllon)

SHENDETESI

Vera Remskar, drejtoreshë ekzekutive e "Foundation Together Kosova" shpjegon si funksionojnë këshillat "online" për problemet psikologjike dhe mjekësore

Ndihmë emocionale për të rinjtë shqiptarë përmes platformës "www.nukjevetem.al"

Projekti i këshillimit 'online' "Nuk je vetëm" bën dy vite, çfarë projekti është ky dhe si ka filluar rrugëtimin e tij?

Fondacioni "Together Albania", në shkurt të vitit 2016 ka lançuar projektin e parë për këshillim "online" për të rinjtë e Shqipërisë www.nukjevetem.al. Vendimi për të sjellë në Shqipëri një shërbim të tillë doli nga një historik 8-vjeçar tashmë të një shërbimi të ngjashëm në Kosovë (www.nukjevetem.net), ngase nga të gjitha pyetjet që merrnin në Kosovë, pothuajse 25% e tyre vinin nga Shqipëria. Si pasojë, lindi nevoja që të rinjtë shqiptarë të kishin një portal të dedikuar vetëm për ta. "Nuk je vetëm" në këto dy vite është vizituar nga 638,300 përdorues dhe ka ofruar mbi 1331 përgjigje me tematika të ndryshme. "www.nukjevetem.al" është një portal që u ofron të rinjtë këshillim "online" falas dhe anonim. Pas këtij shërbimi janë 30 ekspertë mjekë dhe psikologë të mirënjohur në Shqipëri, të cilët ofrojnë këshillimin falas. E gjithë kjo është mundësuar falë mbështetjes financiare të ambasadës norvegjeze.

Përse zgjodhët formën "online" të këshillimit?

Pasi projekti u është dedikuar të rinjve, atëherë forma "online" është më e përshtatshme. Në ditët e sotme të rinjtë janë kryesisht "online", na pëlqen kjo ne apo jo dhe ku më mirë mund t'i takojmë të rinjtë, se sa aty ku ata qëndrojnë shumicën e kohës, pra "online". Një e dhënë që e vërteton këtë fakt është që në këto 2 vite ne jemi kontaktuar nga 185 shtete, që do të thotë se kudo ku ka shqiptarë, kanë arritur të na gjejnë. Pra, nuk ka rëndësi se ku ndodhen fizikisht, nëpërmjet "Nuk je vetëm" është bërë e mundur që ata të marrin ndihmën profesionale në gjuhën e tyre.

Çfarë problematikash mund të adresojnë përdoruesit në portalin tuaj?

Ne kemi marrë pyetje për problematika të ndryshme, që i prekjin adoleshentët që nga pëlqimet e hershme e deri tek çështjet mjekësore, sidomos gjinekologjike edhe urologjike. Sigurisht që problemet psikologjike si ankthi edhe depresioni janë disa ndër temat më të shpeshta. Një numër i konsiderueshëm pyetjesh na vijnë edhe në lidhje me tentativat dhe idetë e vetëvrasjes, abuzimet seksuale, të cilat sigurisht trajtohen në mënyrë urgjente nga ekspertët tanë. Të gjitha këto tema i diskutojmë me të rinjtë drejtpërdrejt në ligjërata që i mbajmë në shkollat fillore dhe të mesme në të gjithë Shqipërinë.

A keni një databazë të dhënash?

Ne jo vetëm që e kemi këtë databazë, por ajo është e formularit shumë mirë, ku çdo pyetje që vjen, kategorizohet për natyrën e problematikës, madje në bazë të tyre u vendos edhe tema e Konferencës së Parë Ndërkombëtare të mbajtur shkurt të vitit që lamë pas.

"Seksualiteti dhe të rinjtë në Shqipëri - Konteksti kulturor, edukimi i pamjaftueshëm seksual në shkollë dhe roli i medias" ishte titulli i konferencës, që e pa çështjen e seksualitetit në katër prizma: kontekstin kulturor, sjellja dhe qëndrimet seksuale të të rinjve, ndikimi i medias si edhe edukimi seksual në shkollë. Ishte një konferencë që përfshiu të gjithë aktorët përgjegjës, ministritë përkatëse, ekspertë ndërkombëtarë, shkollat, fakultetet, medi-

"Sipas parashikimeve të OKB, në 2020 depresioni do të jetë sëmundje kryesore"



at, profesionistë të fushave si dhe të rinjtë. Në çdo vit nxjerrim të dhëna që kemi mbledhur mbi pyetjet më të shpeshta që vijnë nga të rinjtë. Duke marrë parasysh parashikimet e OBSH-së, në vitin 2020 depresioni do të jetë sëmundja kryesore, çka tregon se çrregullimet e shëndetit mendor janë në rritje e sipër gjithandë. Ky trend për fat të keq vërehet edhe mes të rinjve tanë. Prandaj ajo që fondacioni "Together Albania", përmes projektit "Nuk je vetëm" është që të sensibilizojë opinionin e gjerë për rëndësinë e kërkimit të ndihmës rreth problemeve të shëndetit mendor. Fokusi kryesor vazhdon të përqendrohet tek ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes emocionale të të rinjve, ndërtimi i kulturës të kërkimit të ndihmës dhe ulja e stigmës dhe turpmit, i cili zakonisht është shumë i theksuar në shoqërinë tonë.

A ishte kjo një alternativë përballë neglizhencës, nëse mund të themi të institucioneve shtetërore, të prindërve, shkollave, apo është thjesht një novacion? Pra, në çfarë niveli vlerësoni se qëndron vëmendja e shoqërisë ndaj mirëqenies e të rinjve?

Ajo që ne kemi vënë re është që të rinjtë kanë shumë nevojë për këtë lloj shërbimi. Nuk dëshirojmë t'i vëmë gishtin askujt. Ka shumë faktorë, të cilët kanë kontribuar në këtë gjendje, ku për të rinj nuk ka shërbim të nevojshme dhe të përshtatshme për të kërkuar ndihmë brenda sistemit shëndetësor. Për këtë, roli i organizatave si e jona mund të jetë i rëndësishëm në përmblidhjen e këtij boshllëku. Por, në anën tjetër është vetë jeta shumë e shpejtë çka ndikon që prindërit nuk e kanë gjithë kohën që do të kishin dashur për t'ua dedi-

kuar fëmijëve, mësuesit kanë klasa shumë të mëdha dhe nuk arrijnë të dedikojnë kohën e duhur për t'i diskutuar këto tematika mëse të rëndësishme me nxënësit. Nga ana tjetër, të rinjtë jetojnë në një botë krejtësisht të ndryshme nga ajo që kanë jetuar prindërit e tyre. Kanë superinformacion

NDIHMA "ONLINE"

Sipas të gjitha hulumtimeve, është parë se këshillimi në formën "online" është ai që të rinjtë e preferojnë karshi këshillimit ballë për ballë. Këshillimi "online" ka shumë përparësi, pasi është lehtë i aksesueshëm.

përpara tyre që i marrin nga interneti, një burim informatash që jo gjithmonë dinë ta përdorin për t'iu shërbyer atyre. Ajo që është parë në këto dy vite në "Nuk je vetëm" është se të rinjtë e kishin shumë të nevojshme një portal të kësaj natyre, sepse ata vetë na kanë gjetur, ata na kanë kërkuar duke na shkruar pyetje nga më të ndryshmet. Unë di të them gjithashtu që të rinjtë e sotëm përjetojnë dhimbje dhe probleme nga më të ndryshmet, që ndoshta në syrin e një të rrituri janë gjëra vlerësohen si kaluese, por që në syrin e tyre janë gjëra shumë të rëndësishme për të cilat ata kanë nevojë shumë të madhe që të kenë një profesionist mbi kokë. Përparësi më e madhe e "Nuk je vetëm" është që është një shërbim i aksesueshëm për të gjithë të rinjtë e Shqipërisë, pavarësisht se ku ata banojnë, në qytete apo në fshatrat më të thella, me një telefon dhe internet ata kanë akses 24 orë.

Përmendët profesionistët, sa janë ata

dhe si është lloji i angazhimit të tyre me ju?

Ne kemi aktualisht 30 ekspertë në faqe, të cilët ofrojnë ndihmën e tyre krejt vullnetarisht. Ata janë të specialiteteve të ndryshme, si psikologë shkollorë, psikologë klinikë, psikologë të specializuar vetëm për problematikat e adoleshentëve, psikologë që merren vetëm me ankthin apo vetëm me trauma. Kemi gjithashtu psikiatër, mjek dermatolog, gjinekolog, mjek të përgjithshëm, urolog, ortoped, dietologe etj. Ne jemi munduar që të përfshijmë në këtë projekt një gamë ekspertësh, që do të mbulojnë të gjitha problematikat e të rinjve si ato të shëndetit fizik, ashtu edhe ato të brendshme e shpirtërore. Puna vullnetare e të gjithë ekipit është porosia më pozitive që një projekt mund të bartë në shoqërinë shqiptare dhe një shembull i mirë për të gjithë, se çdo individ mund të kontribuojë në fushën e tij të veprimit dhe të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri, sidomos në këtë periudhë tejet të ndjeshme, që ka ndodhur një luhate masive e vlerave në shoqëri, çka prek më shumë të rinjtë dhe shëndetin e tyre.

Interesant është edhe bashkëbisedimi me përdoruesit e tjerë, mendoni se i lehtëson të rinjtë socializimin dhe ndarja e eksperiencave?

Pyetjet janë të hapura për të komentuar nga bashkëmoshatarët, por komentet gjithashtu administrohen. Ne nuk e postojmë asnjë koment me natyrë ofenduese, negative, apo komente që personin që ka shkruar pyetjen do ta bëjnë të ndihje. Qëllimi i faqes është që të jetë ndihmuese, të japë mbështetje dhe të jetë një hapësirë e sigurt për të rinjtë që të ndajnë eksperiencat e tyre me pozitvitetin maksimal.

Sa do t'i ndihmojë të rinjtë këshillimi "online"?

Sipas të gjitha hulumtimeve, është parë se këshillimi në formën "online" është ai që të rinjtë e preferojnë karshi këshillimit ballë për ballë. Këshillimi "online" ka shumë përparësi, pasi është lehtësisht i aksesueshëm, ata nuk duhet të shkojnë askund për të marrë ndihmën që ju duhet, sidomos kur janë në ndonjë situatë krize. Këshillimi "online" nuk mundet ta zëvendësojë këshillimin ballë për ballë, por është një shërbim shumë i mirë për të marrë qoftë edhe ndihmën e parë, apo për t'u drejtuar nga profesionistë në vendin e duhur.

Mendoni se e ka thyer portalin tuaj tabunë e hapjes për problemet psikologjike?

Mendoj që "Nuk je vetëm" ka bërë një hap në këtë drejtim, sidomos tek të rinjtë, duke u hapur një derë në të cilën të rinjtë trokasin në rast nevojë, duke e ruajtur anonimitetin e tyre. Kjo ndjenjë sigurie dhe besimi që kanë krijuar ndaj nesh i bën ata të ndihen rehat mjaftueshëm që me ne të ndajnë problematika mjaft të ndjeshme siç janë, abuzimet seksuale, incesti, dhuna në familje, orientimi seksual dhe idetë për vetëvrasje. Shumica na shkruajnë se jemi të parët me të cilët ata ndajnë këto tregime të dhimbshme nga jeta e tyre. E gjithë kjo na bën të jemi shumë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm për këtë besim, që të ofrojmë ndihmë profesionale, duke e ruajtur gjithmonë anonimitetin e tyre.

Opinion i Ditës

Renzi, Berlusconi apo të dy bashkë?!

Nga Monika Stafa

(Vizion nga faqja e parë)

... vetëm me mënyrën se si qytetarët italianë reagojnë ndaj fluksit të pashtershëm të emigrantëve në hapësirat e tyre publike dhe jo vetëm, por as edhe tërmetit politik që ka nisur prej kohësh në vendin fqinj. Çfarë i sjell ky rezultat Europës, është çka më shumë nga ajo sa shohim në përqark.

Nëse ndjek Tg1 apo çdo edicion informativ tjetër italian, edhe pse nën një logo të ndryshme, qartazi duket se historitë me ndodhi emigrantësh janë të vazhdueshme e deri mahnitëse për nga emocion.

ni, tri herë kryeministër i Italisë, kthehet për çudinë e askujt, sërish në politikë pavarësisht se ishte 'dëbuar' nga zyra prej një dënimi për mashtrim tatimor. Shfaqet i sigurt para kamerave sa herë i duhet të përballlet me to e madje duke iu referuar sondazheve më të fundit të <https://www.termometropolitico.it/elezioni-politiche-2018>, deklaroi se tashmë Qendra e Djathtë ka fituar, edhe pse jo shumë larg në kohë pat paralajmëruar një 'bombë sociale' duke u zotuar se do të deportojë sapo të vijë në pushtet afro 600,000 emigrantë të paligjshëm. Italia është

sociale e juridike për 'të mbërriturit e rinj' në tokën e tyre, duke premtuar në vazhdim investime të mëtejshme mbi sigurinë në plan strategjik. Në shoqërinë italiane, 'frika prej tjetrit' nuk ekziston si koncept. Në radhë të parë, sepse vetë italianët nuk kanë një qasje 'armike' me të huajin dhe së dyti, kjo lloj maniere në sjellje e tyre, është debatuar e tjerë kaq shumë për dekada të tëra e megjithatë ende politikantët e fqinjit tonë nuk arrijnë asnjëherë të gjejnë një zgjidhje të qëndrueshme e të shëndetshme mbi problemet që lidhen me migracionin e parregullit dhe

themelor që duhet mbajtur.

Ndërkaq, këto zgjedhje janë paralajmëruar të jenë shpërthyes, sa i përket debateve televizive, si ajo mes Salvinit dhe Boldrinit apo si ajo që mund të ishte (anulluar më pas) mes Renzit dhe Salvinit. Mbetet gjithmonë e nxehtë, tema e emigracionit si në çdo vend evropian kur zgjedhjet janë në prag dhe shërbejnë si ushqim i mirë për kundërshtarët radikalë. Por ka dhe çështje të tjera, jo më pak të nxehta; si punësimi, shkolla dhe pensionet, por sigurisht me më pak argumente për t'u trajtuar. E gjitha kjo ndërsa 4 marsi po afron çdo orë e



Njerëz shpesh kërrusur që lëvizin në rrugë të paligjshme të qytetit, të rinj të armatosur që nën presionin e karabinierisë ndihen më të tensionuar se kurrë më parë në vendin fqinj, i cili pat shërbyer për dy dekada e më shumë si toka më mikpritëse në Europë për të huajt që kërkonin të ndërtonin një jetë normale. Ngjarjet janë të tmerrshme, vrasje, zhdukje, fshehje trupi nga masakruerit, shpërndarës droge me leje qëndrim të skaduar, arrestime të shpejta e më pas deri politikantët të krahut të djathtë të përfshirë në këtë skenë tensioni që ofron Italia e trazuar jo aq prej emigrimit klandestin sesa prej menaxhimit të dobët të tyre në rrugët e kufijve europiane.

Më shumë se i zemëruar, javë më parë kreu i "Lega Nord", Matteo Salvini, në një nga ato përlshjet e tij publike, akuzoi qëndrën e majtë se e ka kthyer vendin në një kamp refugjatësh. Silvio Berlusconi

të 'lodhur prej zgjerimit'?! Megjithatë ministri i Brendshëm italian, Minniti, shkruajnë ekspertë të çështjeve europiane, është përpjekur ta ulë fluksin emigrantëve në më shumë se 30 për qind gjatë vitit që lamë pas, kjo falë marrëveshjeve të diskutueshme me homologët e tij libianë, çfarë duket se prodhojnë deklarata të tilla si ajo e Berlusconi, sigurisht lë shumë për të dëshiruar. Por një gjë është më se e sigurt, premtime të tilla ksenofobiste në një Europë fragile sot, por që punon ende të ruajë vlerat e diversifikimit multi-kulturor, paralajmëron një rrezik shumë më të madh, atë që urrejtja mund të shkaktojë; pa asnjë mëdyshe një dhunë të re.

Si partia kryesore në koalicionin e tanishëm qeverisës, demokratët për përpigjen të gjejnë një ekuilibër mes penalizimit që u bëhet nxitjeve të ksenofobisë dhe mbrojtjes së politikave të tyre

integrimin e dobët të tyre. Asnjëra prej forcave më të mëdha politike në betejat elektorale duket se nuk janë shfaqur si lojtarë të fortë e të besueshëm mbi këtë çështje. Çfarë ka bërë progres, është vetëm një ligj me prirje më liberale për dhënien e kombësisë fëmijëve të lindur aty, si dhe atyre që arsimohen. Ky ligj i jep një zgjidhje më të qartë barazisë së të drejtave që ata duhet të kenë si të gjithë qytetarët e tjerë italianë. Ky lloj projektligji ka qenë në agjendën zyrtare të qeverive të qendrës së majtë për më shumë se 20 vjet. Gjatë gjithë kësaj kohe, klasa politike në përgjithësi ka argumentuar në debate publike dhe jo vetëm se siguria e vërtetë prej të huajve në një vend, mund të arrihet vetëm nëpërmjet njohjes së tyre dhe përfshirjes së plotë në mjedisin që gjejnë. Por muaji mars, do të shënojë një tjetër legjislaturë të humbur pa këtë premtim

më shumë dhe kur pikërisht atëherë ndërsa po mendohet për skenarët e mundshëm post-elektoral. Statistikat nuk e mendojnë më një rikonfirmim të kryeministrit Gentiloni megjithatë Giorgio Napolitano insiston mbi këtë hipotezë. Në fund nuk duhet ta heqim nga mendja atë që SHBA-të mendojnë, se kush fiton zgjedhjet nuk mund të qeverisë ndërsa Sergio Mattarella po mendon tashmë për lëvizjet e mundshme në rastet e mungesës së një fituesi të vërtetë. Ndjenja e zhgënjimit dhe e dezorientimit të shkakuar nga një dekadë e krizës ekonomike megjithatë, ende e prekshme në xhepat e shumicës së italianëve, kanë krijuar një terren pjellor për këtë qasje të re frike ndaj të huajve. Nisur nga kjo, janë pikërisht këta faktorë, të cilët po shtrijnë rrugën e një stuhie frike prej një të djathtë të dhunshme dhe radikale.

HOROSKOPI

DASHI
Në kontakt me publikun jeni gjithmonë të preferuar, buzëqeshja juaj lehtëson barrën dhe shkrim pakënaqësitë e atyre që janë në pritje. Do të kafoni një mbrëmje shumë të bukur dhe argëtuese në shtëpinë e miqve të juaj.

DEMI
Çifti Pluton-Uran që ju mbështet ju dhuron intuitë të jashtëzakonshme. I perceptoni dëshirat e njerëzve dhe u dini përpara me entuziazëm. Në negociata dhe komunikim vazhdoni të keni mbarësi: kontakti me publikun stimulon ide të reja.

BINJAKET
Nuk do të jeni në humor të mirë nga ndikimi i Hënës. Çifti Merkur-Neptun do të jetë armiqësor, ndërsa perceptimet dhe fantazitë ju nxjerrin jashtë rrugës së qëllimit kryesor. Rreziku, në dashuri, është të synosh për shumë lartë, sidomos nëse jeni ende beqare.

GAFORJA
Pavarësisht të gjithave, Hëna ju flet për të punuar. Për fat të mirë, çifti Merkur-Neptun ju mbështet me një përzirje të mrekulueshme të arsyesh dhe intuitës. Një bisedë e këndshme, ku ndjenjat shprehen hapur, ndihmon në marrëdhëniet në çift.

LUANI
Udhëtime dhe lëvizje të shumta e gjallërojnë ditën e juaj; mund të jeni në tren, aeroport ose thjesht në makinë, ndoshta për të shkuar të takoni miq të largët. Partneri është kokëfortë dhe tekanjor, tregoni diplomaci duke u treguar dakordësi dhe pastaj bëni si të keni dëshirë.

VIRGJERESHA
Do të keni krijimtari të rafinuar. Arti, fotografia dhe muzika nuk janë thjesht hobi, por mund të kthehen mundësi profesioni. Çifti Merkur-Neptun ju mbështet. Do të keni shumë energji, pasion dhe besim në aftësitë e juaj krijuese.

PESHORJA
Nëse kërkoni për persona idealë, nuk duhet të shikoni shumë larg, ndoshta e keni në krah ose jeni në rrugë për ta takuar. Jepini hapësirë argëtimit dhe lëvizjes së mbrëmjes së ditës së solme, duke pranuar ftesë e miqve që ju kërkohen.

AKREPI
Do të jetë një ditë e ndërlikuar, nën tërheqjen e Hënës. Edhe çifti Merkur-Neptun e keni kundra, duke krijuar zënkë në marrëdhënie. Bëni kujdes nga ata, që të bindur se mund t'ua mbushin mendjen, duke ju premtuar qiellin dhe tokën, sepse nga pas ka një kleçkë.

SHIGJETARI
Do të keni frymëzim të shkëlqyer dhe intuitë të denja për një detektiv! Instinkti do t'ju japë udhëzimet e duhura për të arritur pa shumë përpjekje drejt suksesit. Do të përjetoni gjallërinë e miqësisë dhe dashurisë dhe si edhe puna do të ecë: më në fund po filloni të fitoni.

BRICJAPI
Ana e mirë e Merkurit dhe Neptunit garanton frymëzimin krijuese dhe udhëtime në intimitetin e shpirtit. Do t'ju vijnë mesazhe romantike nga larg. Do të keni harmoni në vendin e punës. Nuk do të keni rivalitet me kolegët, shpirti i skuadrës është në interes të grupit.

UJORI
Do të përshkoheni nga ndjenja e të qenit zotëruar, ndoshta më shumë një qëndrim sesa një nevojë e thellë: një ekip ju pëlqen të theksoni se ai ose ajo është tashmë pronë private. Do t'i pëshpëritni në vesh partnerit gjëra konfidenciale. Fletet më bukur për dashurinë në intimitetin e shtëpisë së juaj.

PESHQIT
Do të mbizotërojë shpirti i skuadrës me kolegët, kur njëri nuk ia del e ndihmon tjetri, pa zili dhe kritika, për të arritur objektivin. Investimet do të duhet të monitorohen. Konsultohuni me një ekspert të kësaj fushë. Do të bëni blerje interesante në librarë.

Katovica

Pse Prishtina nuk flet për njohjen e Kosovës nga Serbia?

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

... Ballkanin Perëndimor, e publikuar në datën 6 shkurt 2018, e përkufizon qartë këtë detyrë: "Një marrëveshje e plotë, legalisht detyruese e normalizimit të marrëdhënieve është urgjente dhe vendimtare, që Serbia dhe Kosova të përparojnë në rrugët e tyre respektive europiane".

Për arsye të njohura, që diktohen nga situata e brendshme në BE, ku akoma pesë shtete fillojnë me një marrëveshje dhe Brukseli është detyruar të përdorë eufemizmin "marrëveshje detyruese e normalizimit të marrëdhënieve". Por ky përkufizim eufemistik, në vend që të nxijë palët drejt një përpjekje reale për afim, duket sikur po i largon edhe më tepër nga bashkimi drejt kësaj pike. Duhet thënë që në fillim se përkufizimi "marrëveshje detyruese e normalizimit të marrëdhënieve" është thjesht ribotim i titullit të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, e nënshkruar në Bruksel në 19 prill 2013, me ndërmjetësimin dhe garantimin e BE. Çfarë normalizimi sollti marrëveshja e pesë viteve më parë dhe nëse i normalizoi ajo marrëdhëniet dypalëshe, është e lehtë të jepet përgjigje. Ndonëse ishte marrëveshje ndërkombëtare dhe e garantuar nga BE, që do të thotë se ishte e detyrueshme për të dy palët, nuk u zbatua nga Serbia dhe i la marrëdhëniet në pikën e nisjes në aspektin politik dhe diplomatik. Marrëveshja e normalizimit të marrëdhënieve, kishte në nenet e saj angazhimin dhe detyrimin e Serbisë për të mos penguar Kosovën në rrugën e saj drejt integrimit evropian dhe madje edhe detyrimin mos ta pengonte as pranë palëve të treta integrimin evropian të Kosovës. Ishte një detyrim i pranimit të njohjes së tërthortë të Kosovës nga Serbia, sepse dihet që në BE pranohen shtete dhe jo krahina apo provinca. Mirëpo Serbia e shkeli në mënyrë të përditshme këtë angazhim ndërkombëtar dhe gjatë pesë viteve e ka penguar me çdo mjet procesin e njohjeve ndërkombëtare të Kosovës, siç ka penguar edhe pranimin e saj në organizatat ndërkombëtare që nga UNESCO e deri tek Interpoli. Është vërtet për t'u habitur që Brukseli, si ndërmjetës dhe garant, nuk e kritikoi asnjëherë Serbinë për këtë shkelje të detyrimeve të marrëveshjeve të nënshkuara me Kosovën. Dhe është vërtetë e paqartë se si do ta detyrojë tani, që po kërkon një marrëveshje të re të normalizimit të marrëdhënieve.

Gjatë pesë viteve, në planin politik dhe diplomatik, marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë kanë ngjitur në vend për faj të Serbisë. Atëherë, përse duhet quajtur përsëri "marrëveshje e normalizimit të marrëdhënieve" dhe vetëm i shtohet cilësori "detyruese". A do të thotë kjo se marrëveshja e parë e normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës nuk ka qenë detyruese dhe ka qenë fakultative? Cili është ndryshimi midis marrëveshjes së vitit 2013 dhe kësaj që pritet tani nga BE?

Vendosja e emrave evazive të "normalizimit të marrëdhënieve" ka bërë që Serbia të ndjehet e lirë ta shtojë agresivitetin dhe intransigjencën e saj nacionaliste kundër pavarësisë së Kosovës. Dhjetë

Kërkesa e parë dhe e fundit në një marrëveshje të re detyruese duhet të jetë njohja e Kosovës nga Serbia.



vjet pas pavarësisë së Kosovës dhe tetë vjet pas vendimit historik të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Serbia po kërkon të kthejë mbresa historinë dhe të ringjallë një të ashtuquajtur "çështje të Kosovës" dhe një ridiskutim të statusit të saj. Madje për ta bërë të pranueshëm ab-

anëtarësohet në BE, siç ua tha në tavolinë ministri i Jashtëm gjerman në Beograd në 14 shkurt.

Në situatën aktuale diplomatike të komplikuar del në plan të parë një problem i madh, që lidhet me qëndrimin, që po mban dhe duhet të mbajë Prishtina zyrtare rreth kërkesës së Komisionit Evropian për një

Nuk kuptohet pse udhëheqësit e Kosovës po flasin me terma panegjirikë për "marrëveshje historike" me Serbinë për pranim në OKB dhe nuk flasin për objektivin dhe përmbajtjen kryesore të dialogut, që është njohja e Kosovës nga Serbia.

një memecllëk i pashpjegueshëm i udhëheqësve të Kosovës për kërkesën bazë të njohjes së Kosovës nga Serbia. Nuk kuptohet pse udhëheqësit e Kosovës po flasin me terma panegjirikë për "marrëveshje historike" me Serbinë për pranim në OKB dhe nuk flasin për objektivin dhe përmbajtjen kryesore të dialogut, që është njohja e Kosovës nga Serbia.

Unë e kam theksuar disa herë në anali-

zat e mia që Kosova i ka bërë një favor shumë të madh Serbisë, sepse nëpërmjet hapjes së dialogut me të në Bruksel me axhendën e ngushtuar në tematikën teknike, ajo i dha Serbisë alibinë e avancimit në BE për bisedimet e pranimit. Heshitja dhe harresat e Prishtinës zyrtare lidhur me kërkesën themelore të njohjes nga Serbia ka nxitur një histori të vërtetë të diplomacisë serbe dhe ruse kundër shtetësisë së Kosovës. Dikush e klasifikonte si "idiotësi diplomatike" thirrjen, që ministri i jashtëm serb, Ivica Dačić, në 22 shkurt në prani të ministrit të jashtëm rus në Beograd, i drejtoi SHBA dhe Britanisë së Madhe që të tërheqin njohjen e Kosovës. Kjo idiotësi diplomatike nuk është e rastit, por shpreh inkurajimin e Beogradit nga heshitja, po ashtu idiote, e Prishtinës për njohjen e detyrueshme nga Serbia. Përpara kësaj njohje të detyrueshme nuk ka vlerë as dialogu dhe as OKB-ja. Unë nuk kam informacion se cili nga këshilltarët jugosllavë i ka këshilluar Prishtinës këtë qëndrim, i cili po kulmon me tezën e re proserbe në qarqet zyrtare të Prishtinës se "Nuk ka nevojë që Serbia ta njohë Kosovën".

Në datën 15 shkurt ish-kryeministri i Suedisë, Karl Bildt, një nga diplomatët më të shquar evropianë dhe një nga ekspertët më të mirë ndërkombëtarë të Ballkanit, në një analizë të tij për strategjinë e re të BE për Ballkanin Perëndimor, botuar në "ecfr.eu", hedh tezën se "është krijuar një e drejtë veto e Kroacisë dhe e Kosovës për hyrjen e Serbisë në BE". Veto e Kroacisë lidhet me zgjidhjen e grindjes kufitare me Serbinë për 135 kilometra përgjatë lumit Danub, ku Kroacia kërkon që për kufirin të respektohet shtrati i vjetër i lumit dhe jo ai i ndryshuar nga ndërhyrjet inxhinierike. Sipas Bildtit, veto e Kosovës lidhet me procesin e dialogut dhe të marrëveshjes detyruese të normalizimit, që kërkon Brukseli, para pranimit të Serbisë. E shprehur më thjesht, kjo do të thotë që Kosova mund ta ndalojë Serbinë për në BE, nëse Serbia nuk e njeh Kosovën.

Kërkesa e parë dhe e fundit në një marrëveshje të re detyruese duhet të jetë njohja e Kosovës nga Serbia. Nëse Prishtina do të devijojë nga ky objektiv strategjik imediat dhe do të verë firmën në ndonjë marrëveshje, ku shpërblimi do të jetë një anëtarësim në OKB pa njohjen si shtet, kjo do të quhet një autogol i madh i udhëheqësve të Kosovës, (për të mos përdorur një term akoma më të rëndë, që e preferon populli).

Prishtina, siç e ndriçoi me largpamësi diplomatik i madh suedez, ka tani në dorë veton e saj për anëtarësimin e Serbisë në BE. Është një rast i artë diplomatik, që nuk duhet ta djegë për flamarinë në OKB. Është një kartë e artë diplomatike, që duhet t'i shërbejë interesit shtetëror dhe kombëtar të Kosovës për kushtin e parë dhe të fundit: njohja e Kosovës si shtet nga Serbia. Asnjë kompensim tjetër nuk mund të vihet në plan të parë, as UNESCO e as OKB. Ndaj thirrja ime drejtuar presidencës, qeverisë dhe diplomacisë së Kosovës është që në mënyrë kategorike produkti i një marrëveshjeje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë njohja reciproke midis dy shteteve fqinje.

VJEN TROFEU I PARË PËR GUARDIOLËN



Manchester Siti ka fituar trofeun e parë të "epokës Guardiola" duke

mundur në finalen e Kupës së Ligës skuadrën e Arsenalit me shifrat 3-0. Goli i

Siti mposht Arsenalin 3-0 në finalen e Kupës së Ligës

parë në këtë ndeshje u shënu në minutën e 18 nga Serxhio Augero, i cili ka realizuar në 5 ndeshje radhazi golin e parë për ekipin e tij. Goli i dytë u shënu nga Kompani në minutën e 58, ndërkohë që vetëm 7 minuta më vonë, David Silva ka trefishuar rezultatin duke

vulosur dhe takimin. Kjo fitore ka qenë, në fakt, vazhdimi i një traditë të çuditshme, pasi gjithmonë në vitet e Botërorëve, ky trofe fitohet nga një ekip i qytetit të Manchesterit. Në vitin 2006, kur luhej Botërori në Gjermani, fituesi i kësaj Kupe ka qenë ekipi i Manchester Juan-

jtid, ndërkohë që në 2010 kur Botërori luhej në Afrikën e Jugut, Manchester Junajtdi e fiton sërish këtë trofe. Epoka e Sitiit ka nisur në 2014, kur Botërori luhej në Brazil, ndërsa sot, në 2018 është përsëri Siti fitues duke i paraprirë Botërorit të Rusisë. Se kush do ta fitojë kampionatin në vitet në vazhdim nuk dihet, por historia thotë se fituesi i Kupës së Ligës pas 4 vitesh do të jetë përsëri një ekip nga Mançestëri.

Luftëtari kap në renditje Partizanin, ndërsa kuqeblutë ruajnë distancën me Teutën

Abazaj e Bregu pa shënjestër, Vllaznia merr pikë në Gjirokastrë

Mbyllet 0-0, por çfarë shpërdorojnë vendësit



Jeton Selimi

Luftëtari dhe Vllaznia nuk shkojnë më larg sesa një barazim pa gola, ndërsa ky rezultat i shkon më shumë për shtat shkodranëve, të cilët ruajnë kështu distancën me Teutën e vendit të parafundit, ndërsa gjirokastritët këmbëjnë vendin me Partizanin, duke i zbritur këta të fundit në vendin e shtatë. Miqtë vinin në këtë përballje edhe pas ngjarjes së shëmtuar të kësaj jave, ku u tentua të goditen me thikë trajneri Gjoka, çka padyshim ka ndikuar psikologjikisht te kuqeblutë. Vendësit e nisën më mirë takimin, kur në minutën e 12-të Shkurtaj detyron Sherin të bëjë një pritje të vështirë, ndërsa më pas Rrapa nuk arrin të shtyjë në rrjetë. Abazaj bën në minutën e 16-të një nga ato shpërthimet e tij, por do të gjuajë jashtë kuadrantit. Vllaznia

nuk ka forcë të godasë në sulm, ndërsa Sukaj në fund të pjesës së parë arrin të vjedhë një top, por rikuperon në kohë mbrojtja. Me



fillimin e pjesës së dytë, Luftëtari ka ndryshuar marsh, ndërsa Abazaj humbet një rast të artë. Aksion i rrjedhshëm i gjiroka-

stritëve, që nxjerrin Kristal Abazajn të vetëm me Sherin, por godet çuditërisht jashtë. Sërish numri 7 i gjirokastritëve, që provon

nga i njëjti kënd, por kësaj radhe ndalet nga Sherri. 2 minuta më pas është Bregu që siluron Sherin me këtë të fundit që grushton në vështirësi, ndërsa me topin e mbetur në zonë, portieri bën një tjetër ndërhyrje shpëtimtare ndaj Abazajt. Vllaznia shfaqet në minutën e 67-të, kur Gilman Lika provon me të majtën në hyrje të zonës, por topi del pak mbi tra. Në kohën shtesë Vucaj shërben për Ribajn, pas një kundërsulmi të shko-

dranëve, por ky i fundit godet shumë lehtë, ndërsa në limitet e ndeshjes provon dhe njëherë Dejvi Bregu, por dhe ky pa shënjestër e duhur.

PËRCAKTOHET KALENDARË

Java e 23-të në dy ditë, Kukësi-Skënderbeu luhet të mërkurë

Kategoria Superiore pasi ka mbyllur dje javën e 21-të, do të rikthehet të mërkurë me tre takime dhe të enjten me dy të tjera për llogari të javës së 22-të. Tre takimet e ditës së mërkurë do të luhen në të njëjtin orar, në orën 14:00, ndërsa ata të ditës së enjte do të jenë nën ndriçimin e projektorëve, pra në orën 17:00. Pak a shumë të gjitha janë përballje të forta në letër, teksa edhe në fushë do të shihet kjo gjë, pasi veç Skënderbeut që e ka pothuajse të sigurt një dorë të titullit kampion dhe Lushnja që pothuajse qehet e rënë, të tjerat luftojnë për mbijetesën dhe për Europën.

JAVA E 22-të TË MËRKURËN

- Laçi - Vllaznia
- Kamza - Teuta
- Kukësi - Skënderbeu
- Partizani - Lushnja

TË ENJTEN

- Flamurtari - Luftëtari

DREJTORI SHQIPTAR I LACIOS

Tare: Në verë refuzova 70 mln euro për Saviç

Igli Tare ka folur dje për rrugëtimin që pret Lacion në vijimin e sezonit dhe objektivat që ka kjo skuadër deri në mbyllje të një edicioni që duket relativisht i suksesshëm si në Serinë A, ashtu edhe në Ligën e Europës ku ka arritur mes 16 skuadrave më të mira. Drejtori sportiv, në një prononim për "Premium Sport", ka sqaruar shumë gjëra, duke filluar nga merkato, për të vazhduar të plani që ka për përforcimin e ekipit apo te elementët që ka në përbërje grupi që i ka vënë në dispozicion trajnerit Inzaghi. "Luiz Felipe i ka fituar vetë hapësirat për të luajtur këtë vit. Për të ardhmen do të jetë një pikë referimi i rëndësishëm për këtë Lacio. Ajo që vlen më shumë se statistikisht personale është rezultati sportiv. Skuadra është ndërtuar për të arritur disa objektiva dhe deri në fund të vitit nuk do ta kemi më mendjen te merkato. Zërat e merkatos janë pjesë e punës dhe duhet të mesojmë të bashkëjetojmë me to. Disa lojtarë kanë një vlerë shumë të lartë. Në verë kemi refuzuar 70 milionë euro për Milinković-Saviç, por objektivi i Lacios është të bëhemi një pikë mbërritjeje dhe nevojitet një rritje e rëndësishme. Nëse do të ketë shitje, do të bëhen për të mbajtur klubin. Ne duam të fitojmë Ligën e Europës dhe të arrijmë kështu Ligën e Kampioneve bashkë me tifozët tanë, kjo është ëndrra jonë. Objektivat janë ende të realizueshëm dhe derisa të jetë kështu, do të impenjohemi në të gjithë këto fronte. Nuk do ta injorojmë Ligën e Europës edhe pse objektivi kryesor mbetet arritja e Ligës së Kampioneve", - tregoi Tare.

MBROJTËSI

Gjimshiti: Na djegin dy golat e Interit

Benevento luajti vërtet mirë dje në mbrëmje ndaj Interit, por në fund u mund 2-0, nga dy episode. Berat Gjimshiti, mbrojtësi shqiptar i skuadrës së Beneventos, për këtë ndeshje është shprehur: "Kemi për-suar dy gola naivë, jo nga aksione loje, ndaj dhe janë episode që duhen riparë, sepse na "djegin" shumë këta dy gola. Duhet të mësojmë nga këto gabime. Penalltia e Kataldi? Për mua ishte. Për fat të keq, VAR-i nuk e sinjalizoi dhe nuk mund të bëjmë asgjë. Parazitje jonë ishte mjaft pozitive, pasi i lamë pak hapësirë një skuadre si Interi. Ishim të vendosur mirë dhe duhet të marrim gjërat pozitive për ndeshjet e radhës. Ndeshja me Veronën do të jetë vendimtare. Luajmë para tifozëve dhe duhet të fitojmë patjetër".



KUQEZINJTË E TETOVËS

Shkëndija fluturon +11 nga Vardari i vendit të dytë

Ecuria e Shkëndijës në këtë sezon, duket se po shpërblehet pasi është më pranë se kurrë me titullin kampion. Ditën e djeshme, kuqezinjtë e Tetovës kanë mundur me rezultatin 1-0 ekipin e Akademija Pandevit, me golin e Hasanit, një ndeshje e cila u luajti në Tetovë, në një fushë të mbushur me dëborë, duke vështirësuar lojën. Kjo fitore e shkëput Shkëndijën në vendin e parë me 11 pikë më shumë se Vardari i vendit të dytë. Në këtë ndeshje i përmbante të gjitha, ku në minutën e 21 ekipi i Shkëndijës mbeti me 10 futbollistë pas daljes me karton të kuq të mesfushorit Fazlagiq. Numri i kartonëve të kuq u barazua në minutën e 53, kur Çeshmediev nga ekipi i Pandev, shkaktoi një ndërhyrje të gabuar duke u ndëshkuar. Në minutën e 78, ka qenë kapiteni i ekipit, Ferhan Hasani që ka kaluar në avantazh kuqezinjtë, duke i dhënë edhe një tre pikësh mjaft të çmuar tetovarëve. Në barazim 3-3 ka përfunduar ndeshja mes Pobodës dhe Shkupit, ku bardheblutë e Shkupit nuk kanë mundur të administrojnë rezultatin 0-2, duke u përmbytur në 3-2 për Pobodën. Vetëm 5 minuta nga fundi, Asani ka barazuar për Shkupin.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

